



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

RAPORT VJETOR 2023

Korporata Energjetike e Kosovës ShA



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Për:	Bordin e Drejtorëve KEK ShA
Përmes:	Bekir Gerguri, UD. Kryeshef Ekzekutiv KEK ShA Ramadan Budakova, UD zv. Kryeshef Ekzekutiv KEK ShA Alban Krasniqi, UD. Sekretar I Korporatës KEK ShA
Dijeni:	Gramos Hashani, Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit KEK ShA
Prej:	Gazmend Amaxhekaj, Zyrtar I Lartë I Rreziqeve
Tema:	Raporti Vjetor 2023
Data:	24 Prill 2024

Ky raport është përgatitur në bazë të kërkesave ligjore të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet Raportim Financiar dhe Auditim dhe udhëzimit MF-NR. 07/2019 për Strukturën Përmbajtjen dhe Dorëzimin e Raporteve Financiare Vjetore. Përgatitja e tij ka për bazë Pasqyrat Financiare të KEK Sha për vitin 2023, të audituara të dt. 24.04.2024

Përbajtja

NË VEND TË HYRJES	4
RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE	5
Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes	5
Informacion lidhur me Kapitalin dhe Dividendën	6
Të dhënat për Drejtorët Jo-Ekzekutiv	7
RAPORTI I DREJTORIT MENAXHUES	8
Ngjarjet Kryesore të vitit 2023	8
Marrëdhëniet me publik dhe komunitete	10
Burimet Njerëzore	12
Departamenti i Mjedisit	13
Siguria Fizike dhe të tjera	14
Performanca Operative dhe Indikatorët kyç të Performancës	14
Divizioni i Prodhimit të Qymyrit	15
Divizionet e Prodhimit të Energjisë Elektrike	16
PERFORMANCA FINANCIARE	17
Pasqyra e të ardhurave	20
Pasqyra e shpenzimeve	22
Gjendja e Kompanisë	25
Progresi i Projekteve Kapitale	28
Shpenzimet kapitale dhe projektet	28
Divizioni i Mihjeve	29
Divizionet e prodhimit të energjisë elektrike TCA dhe TCB	29
Drejtoria Qendrore	30
PLANI I BIZNESIT DHE PERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM	30
Ambienti	35
Plani i Divizionit të Mihjeve	37
Plani i Divizioneve TCA dhe TCB për gjenerimin e energjisë	37
MENAXHIMI I RREZIQEVE TË KORPORATËS	38
Identifikimi i rreziqeve	39
Rreziku i çmimeve	43
Aftësia negociuese	44
Rreziku i kreditimit	45
Rreziku nga kthimi në investime	46
Rreziqet e likuiditetit	47
Rreziqet operative	48
Rreziku i mos-realizim të buxhetit	48
Rreziqet e përputhshmërisë	50
Masat për menaxhimin e rreziqeve	51
RAPORTIMET SHITESË PËR AKSIONARIN	53
Qeverisja korporative	53
Kultura e menaxhimit të rrezikut	54
Përkrahja për komunitetin	55
Funksionimi i kontrolleve të brendshme	55
Menaxhimi financiar dhe kontrolli	55
Zyrtari i për shmangien e konfliktit të interesit	57
Zyra e Auditimit të Brendshëm	57
Zyra Ekzekutive për Përputhshmëri Institucionale dhe Organizative (ZEPIO)	58
Përmbledhja e të gjitha procedurave gjyqësore	58
Transaksionet e Konsiderueshme	60
Raportet me KPMM dhe Institucionet tjera	60
SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR TË ARDHMEN	61
STRUKTURA ORGANIZATIVE KEK SH. A	63
PASQYRAT FINANCIARE	64

Në vend të hyrjes

Edhe gjatë vitit 2023 stabiliteti i prodhimit të energjisë dhe rritja e kapaciteteve për KEK mbetet njëra nga sfidat kryesore. Efektet post krizave të fundit vërehen në sektorin e energjisë duke shkaktuar zhvendosjen në kohë të projekteve të donacionit të BE-së, rrjedhimisht duke ndikuar edhe në procesin e investimeve të lidhura me rivitalizimin e TCB. Megjithatë një zhvillim i rëndësishëm për KEK gjatë vitit 2023, ishte aprovimi i strategjisë së energjisë i Republikës së Kosovës, duke i hapur rrugën investimeve të reja në sektorin e energjisë. Shto kësaj edhe efektet e krizave (mungesa e energjisë në treg dhe çmimet e larta), të cilat përshpejtuan nevojën e vendit për rritjen e kapaciteteve të brendshme të energjisë, në mënyrë që të zvogëlohet varësia energjetike. Në këtë drejtim KEK gjatë vitit 2023 ka realizuar aktivitete, në drejtim të investimeve në energji të ripërtrishme me bazë solare si dhe përgatitje për tenderim për rindërtimin e njësive A3.

Sa i takon prodhimit, si rrjedhojë e remonteve të planifikuara dhe investime kapitale në njësitë gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike në vitin 2023, energjia e prodhuar ose në dispozicion për treg ishte për 13% më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Energjia e prodhuar gjatë vitit 2023 ishte 4.93 milion MWh e cila krahasuar me vitin paraprak është për 0.74 milion MWh më e vogël (2022: 5.7 milion MWh). Si rrjedhojë e kërkesave më të vogla për thëngjill sipas bilancit të energjisë por edhe nga mosrealizimi i planit për shitjen e jashtme të thëngjillit, gjatë vitit 2023 KEK kishte një rënie të ndjeshme të prodhimit të thëngjillit me 17% krahasuar me vitin paraprak. Prodhimi i thëngjillit në 2023 u realizua në 6.9 milion ton (2022: 8.3 milion ton).

Edhe gjatë vitit 2023 KEK ka vazhduar me performancë pozitive financiare, duke realizuar një fitim neto prej €12.9 milion. Dallimi i madh në rezultatin financiar krahasuar me vitin paraprak, në të cilin ndikim kishte rritja e jashtëzakonshme e çmimeve të energjisë dhe sasia më e madhe e energjisë në dispozicion. Rezultati financiar, pasqyron edhe efektet e stabilizimit të çmimeve e cila dha efekt në të hyrat nga veprimtaria e korporatës, të cilat në 2023 ishin €180.8 milion (2022: €283.5 milion).

Rezultati i mirë financiar, bën që korporata të gëzojë likuiditet të lartë dhe të mos rrezikoj me problemet e shlyerjes së detyrimeve të veta afatshkurtër. Megjithatë dy nga sfidat kryesore me të cilat duhet të fokusohet KEK, lidhen me nivelin e realizimit të investimeve kapitale, e cila paraqet një rrezik të cilin duhet menaxhuar me kujdes në periudhat në vijim, në mënyrë që të realizoj

qëllimin e vet për stabilitet në prodhimin e energjisë. Poashtu, KEK vazhdon të ketë probleme në numrin e stafit si dhe në moshën e shtyer të tij. Përkundër angazhimit në plotësimin e stafit, korporata ka filluar vitin 2023 me 3436 punëtorë, ndërsa në fund të vitit kishte 3341 punëtorë.

Raporti I Bordit të Drejtorëve

Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes

Bordi i drejtorëve të KEK funksionon në përbërje të plotë dhe operon me kompetencë në realizimin e aktiviteteve të rregullta për vitin 2023. Ndër të tjera, BiD ka monitoruar dhe udhëhequr me kujdes operacionet strategjike të përgjithshme, duke fokusuar kryesisht në realizimin me sukses të planeve operative dhe kapitale. Po ashtu, ka përmbushur detyrimet për vendimmarrje dhe në vendosjen e rregullave korporative. Këto përgjegjësi përfshijnë krijimin dhe zbatimin e rregullave të brendshme për të siguruar funksionimin e qetë të ndërmarrjes, sigurimin e burimeve të mjaftueshme për të ofruar shërbimet në mënyrë etike, ekonomike dhe efikase, si dhe mbrojtjen e integritetit të të dhënave ndërsa respekton ligjet për të përmirësuar vlerën e aksionarit.

Edhe gjatë vitit 2023 KEK vazhdon të jetë në një situatë të paqartë sa i takon skemës organizative. Me ndryshimet e shumta në sektorin energjetik dhe në KEK në veçanti në dekadën e fundit, ndikimet në performancën financiare dhe operative do të ndikohen shumë edhe nga qasja strategjike ndaj çështjes së rishikimit funksional të strukturës organizative, e cila pashmangshëm është trajtuar gjatë vitit 2023, megjithëse nuk kishte një epilog të qartë.

Në kontekst të qeverisjes së mirë dhe kontrollit financiar, BiD në vazhdimësi ka shqyrtuar performancën financiare dhe operative të korporatës gjatë takimeve të veta, por dhe brenda Komitetit të Auditimit. Aktivitetet kryesore për vitin 2023, përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm në) Arovimin e Raportit Vjetor 2022, si dhe Pasqyrat Financiare të KEK për 2022 të audituara. Gjatë vitit 2023, bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e menaxhimit të rreziqeve të korporatës për 2023, duke përcaktuar me këtë edhe shkallën e rrezikut për korporatën. Po ashtu, BiD ka aprovuar rishikimin e buxhetit vjetor për vitin 2023 dhe ka aprovuar buxhetin e KEK për periudhën afatmesme 2024-2026, duke synuar edhe sigurimin e mbikëqyrjes më të kujdesshme në procesin e menaxhimit të buxhetit në përputhje me objektivat korporative.


Edhe gjatë vitit 2023, bordi nën synimet për vlerësimet e performancës si dhe me qëllim që të promovoj sjelljen etike dhe përgjegjësinë shoqërore korporative kanë marrë masa për emërimet dhe shkarkimet ose pezullimet e pozitive të larta në korporatë. Po ashtu, Bordi i Drejtorëve ka qenë aktiv në takimet me nivelet e ndryshme të Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare për të diskutuar çështje strategjike lidhur me korporatën. Në kuadër të detyrave të veta, ka realizuar edhe mbledhjen e përgjithshme vjetore

me aksionarin, e cila është mbajtur me dt. 30.08.2023.

Gjatë vitit 2023, janë mbajtur 15 takime të Bordit, dhe 12 takime të Komisionit të Auditimit. Në kuadër të Bordit të Drejtorëve nuk kanë vepruar komitete të përkohshme. Kompensimi i anëtarëve jo-ekzekutiv është realizuar konform ligjit për NP, neni 20, dhe vendimit të Aksionarit nr. 07/81, dt 23.03.2016.

Informacion lidhur me Kapitalin dhe Dividendën

Edhe në vitin 2023, ka vazhduar përmirësimi në strukturën e kapitalit, dhe kjo kryesisht si rrjedhojë e uljes së detyrimeve financiare dhe vazhdimit të trendit të operimit me performancë pozitive nga ana e KEK. Dallimet mes viteve është shkalla e fitimit, e cila në vitin 2022 ishte e jashtëzakonshme, si rrjedhojë e mbajtjes së prodhimit të lartë dhe rritjes së çmimeve (kryesisht pjesa e eksportit). E rëndësishme është që KEK vazhdon të jetë ndërmarrje fitimprurëse, si elementi kryesor që ka ndikuar në rritjen e kapitalit të aksionarit. Kapitali i aksionarit, në kuadër të rritjes së vlerës për investimet e realizuara dhe nga operimet e saj, është rritur për shumën e fitimeve të mbajtura të vitit € 12.9 milion si dhe për rezervën e rivlerësimit me €44.73 milion. Kapitali i kompanisë është rritur në € 378.1 milion në 2023, duke reflektuar strukturën kapital/detyrime në 63% kapital me 37% detyrime në 2023, krahasuar me strukturën kapital/detyrime të vitit 2022, e cila kishte në 54% kapital me 46% detyrime. Ndryshim të ndjeshëm në këtë strukturë kishte edhe rivlerësimi i tokave.



Edhe gjatë këtij viti, KEK nuk ka pranuar kredi ose financime të jashtme shtesë për investime. Megjithëse, për projektin e solarëve ka filluar negociatat me Banka Evropiane për Investime (EIB), si dhe janë në proces negociata mes KEK dhe KfW për financimin e projektit. Nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar shlyerja me kohë e detyrimeve të borxhit afatgjatë, të pranuar në vitet 2008-2012. KEK ka marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe ri-programimit të saj në vitin 2015, të cilës i përmbahet. Gjatë vitit 2023 është shlyer pjesa afatshkurtër e huamarrjes në vlerë prej €11.4 milion.

(në EUR '000)	31.12.2023	31.12.2022
Pjesa afatgjatë		
Kredi me interes nga Ministria e Financave	103,992	115,380
	103,992	115,380
Pjesa afatshkurtër		
Kredi me interes nga MF - Pjesa afatshkurtër	11,387	11,387
Interesi i akrual (jo i vonuar)	609	639
	11,996	12,026
Gjithsej huazimet	115,988	127,406

Përkundër konsolidimit të pozitës financiare, edhe këtë vit korporata nuk ka planifikuar të ndaj dividendë për aksionarin, për shkak të planeve për zgjerim dhe për rritjen e stabilitetit të prodhimit të energjisë elektrike të cilat e bëjnë të nevojshëm ri investimin e fitimeve të mbajtura të korporatës.

Gjatë kësaj periudhe, përkundër rritjes së daljes së parasë për blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve kapitale në vlerën prej €35.1 milion (2022: €10.1 milionë). Ndër këto investime, në vlerë më të madhe dhe të rëndësishme përfshijnë projektin e dilatimeve në TCB, si dhe shpronësimet e tokave në DPQ, remonti kapital i Bllokut A5. Po ashtu ka pasur aktivitete për përmirësimin e ndikimit mjedisor nga termocentralet, investimet të tjera në Miniera dhe termocentrale. Megjithëse, gjatë vitit 2023 bordi dhe menaxhmentit ka vendosur në prioritet krahas rritjes së investimeve në stabilitet të prodhimit, investimet në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorë përmes investimeve në mensa dhe investimet në ambient, efektet post krizës energjetike dhe të pandemisë kanë shkaktuar vonesa në realizimin e këtyre aktiviteteve duke bërë që ato të mos realizohen sipas planit.

Të dhënat për Drejtorët Jo-Ekzekutiv

Ne pajtim me nenin 15 të Ligjit 03/L-87 për ndërmarrjet publike aksionari, në këtë rast Qeveria e Kosovës emëron dhe shkarkon anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore. Mbi këtë bazë, konform nenin 15 ose 16 të Ligjit për NP, me vendimin me nr.02/52 të dt. 02.02.2022, pas përfundimit të procedurave të rregullta, Aksionari ka përzgjedhur Bordin e përhershëm të KEK ShA me mandat tre vjeçar.

1. Z. Skender Haziri, kryesues;
2. Znj. Merita Kasapolli, anëtare;
3. Znj. Valbona Raifi - Deshishku, anëtare,
4. Z. Mustafa Pllana, anëtar;
5. Z. Valdrin Krasniqi, anëtar.

Si dhe kryeshefi ekzekutiv sipas detyrës zyrtare.

Gjatë vitit 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin e dt.15.10.2023 me nr.01/166 për plotësim ndryshim të vendimit 02/52, ka plotësuar dhe ndryshuar përbërjen e Përbërja e Bordit, duke emëruar

1. Z. Arton Ahmeti Kryesues Bordi
2. Z. Skender Haziri, anëtar;

Gjatë vitit 2023, në kuadër të bordit të drejtorëve ka funksionuar komisioni i auditimit, në kuadër të BtD,

është në këtë përbërje:

6. Znj. Valbona Raifi - Dëshishku, kryesuese
7. Valdrin Krasniqi – anëtar dhe
8. Merita Kasapolli –anëtare

RAPORTI I DREJTORIT MENAXHUES

Ngjarjet Kryesore të vitit 2023

Në funksion të realizimit të qëllimit i korporatës i cili është ofrimi i energjisë elektrike, të bazuar në kosto dhe sa më miqësore ndaj mjedisit, dhe e prodhuar nën procedura transparente dhe sjellje profesionale dhe etike, Korporata Energjetike e Kosovës, ka realizuar në nivel të kënaqshëm objektivat e saj të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve dhe në linjë me qëllimin. Realizimi prej 91% i planit të prodhimit të energjisë elektrike sipas Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike (BVEE), e diktuar nga faktorë të ndryshëm që do të shtjellohen më tej në këtë raport. Prodhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2023 ishte 4.93 milion MWh e cila krahasuar me vitin paraprak është për 0.74 milion MWh më i vogël (2022: 5.7 milion MWh). Si rrjedhojë e kërkesave më të vogla për thëngjill sipas bilancit të energjisë por edhe nga mosrealizimi i planit për shitjen e jashtme të thëngjillit, gjatë vitit 2023 KEK kishte një rënie të ndjeshme të prodhimit të thëngjillit me 17% krahasuar me vitin paraprak. Prodhimi i thëngjillit në 2023 u realizua në 6.9 milion ton (2022: 8.3 milion ton).

Realizimi i planit të prodhimit dhe faktorët e tregut (si lëvizja e çmimeve në bursa) kanë ndikuar në realizimin e të hyrave më të ulëta se vitin paraprak me një diferencë të ndjeshme në total të hyrat prej 37.3% në krahasim me vitin paraprak.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve të veta gjeneruese, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme në drejtim të realizimit të projektit të solarëve. Banka Evropiane për Investime (EIB) ka dërguar një dokument për vlerësim dhe komentim nga komisioni, duke përfunduar aktivitetin e konsulentit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe duke marrë miratim mjedisor. Kanë përfunduar analizat gjeoteknike për projektin, duke konfirmuar përshtatshmërinë e terrenit për zhvillimin e projektit të solarëve. Kanë përfunduar aktivitetet për zgjedhjen e kompanisë konsulente për përgatitjen e dosjes së tenderit për parkun solar, si dhe janë zhvilluar aktivitete në finalizimin e marrëveshjeve KEK-KfW. Në proces nënshkrimi i marrëveshjes baze me EIB si dhe marrëveshjen e veçante mes KEK dhe KfW për grantin dhe kredinë.

Nga ana tjetër, kanë vazhduar aktivitetet në njësitë ekzistuese të prodhimit duke përfshirë: aktivitetet për shpronësimin e tokave për qëllime minerare, ku në vazhdimësi mbetet të zhvillohen aktivitete në drejtim

të shpronësimit të 72 hektarëve dhe një shtesë prej 28.3 hektarëve, realizimin e projektit për rindërtimin e njësisë A3 të TC Kosova A, dhe ekzekutimin e projekteve ekzistuese sipas planeve.

Gjatë vitit 2023 sfidë ishte edhe shitja e energjisë për Trepçën, dhe realizimi i uljes së borxhit të saj në €0.5 milion. Shkëmbimi me KESH dhe ndikimi i tij në eksport, si dhe operacionet në Alpex, paraqesin sfida shtesë. Po ashtu gjatë vitit 2023 janë rekrutuar një numër prej 181 punëtorëve të rinjë të profileve teknike, megjithëse sfidë mbetet rekrutimi i vazhdueshëm përmes konkurseve për punëtorë dhe sigurimi i ushqimit për punëtorët i cili synohet të realizohet gjatë vitit 2024.

Gjatë viti 2023, janë marrë masa në funksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme ku janë lëshuar një sërë Urdhëresa Ekzekutive dhe vendimesh me qëllim rregullimin e aktiviteteve të brendshme të funksionimit të korporatës ose edhe për respektimin e kërkesave ligjore ose vendime të institucioneve të ndryshme.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar një sërë marrëveshesh bilaterale me institucione vendore dhe ndërkombëtare për avancimin e mëtejshëm të qëllimeve dhe objektivave të KEK. Disa nga aktivitetet:

- Amendamenti i marrëveshjes për furnizim me shumicë për çmimet e energjisë elektrike për KEDS dhe KESCO për periudhën 14 Shtator 2023;
- Amendamenti i marrëveshjes për çmimet e furnizimit me shumicë për mbulimin e humbjeve KOSTT, po ashtu në Shtator 2023
- Aneks marrëveshja për çmime për furnizimin me energji termike të TERMOKOS Tetor 2023 .
- Ka vazhduar aktivitetet në bazë të Marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll në mes të KEK dhe Ministrisë së Ekonomisë është realizuar gjatë 2022, si dhe aktivitetet në bazë të marrëveshjes për shitblerjen e importit të energjisë elektrike mes KEK dhe KESCO në lidhje me marrëveshjen e Ministrisë së Ekonomisë për subvencionet; etj.

Edhe gjatë vitit 2023, kishte vështirësi në realizimin e investimeve kapitale duke shkaktuar mos realizim të objektivave të parapara në planin e biznesit si dhe përmirësimit të parametrave kyç të korporatës. Për këtë, shkaktarë kryesor mund të konsiderohet vonesat në realizimin e donacionit të BE për elektrofiltrave, i cili ka për shkak të kohës së gjatë të ndalesës së blloqeve, ka shkaktuar edhe vonesa në realizimin e projekteve të KEK.

Megjithatë, KEK vazhdon të jetë një korporatë financiarisht e vet-qëndrueshme, duke realizuar një fitim prej €12.9 milion në vitin 2023. Po ashtu, KEK është kompani me likuiditet të lartë financiar dhe ka vazhduar të investojë në projekte kapitale me mjete vetanake, në kapacitetet e saja prodhuese dhe gjeneruese të energjisë elektrike, si dhe investime kapitale në përmirësimin e ambientit për të cilat synohet të rritet fokusi në vitet në vijim. Janë realizuar aktivitete të prokurimit dhe një sërë prej tyre janë në proces ekzekutimit të

punëve, për të bërë të mundur arritjen e objektivave. Megjithatë, realizimi i projekteve në disa raste është i ndikuar edhe nga ankesat në OSHP dhe periudha e gjatë e trajtimit të tyre.

Në total, gjatë vitit 2023, janë prodhuar 4.9 GWh energji elektrike, si dhe është eksportuar energji elektrike në shume prej € 26 milion.

Sfidë rëndësishme për KEK mbetet riaftësimi ose zëvendësimi i asetëve kryesore të gjenerimit të energjisë në TCA. Investimet në miniera për të rritur kapacitetet e prodhimit dhe për të rritur sigurinë e operimeve si dhe ri vitalizmit të planifikuara tashmë në TCB. Të gjitha këto kanë një ritëm të ngadaltë të realizimit në masë të madhe për shkak të faktorëve të ndryshëm jashtë KEK. Megjithatë përparësi e KEK është se nevojat për investime dhe orientimin strategjik e ka të definuar me raporte të pavarura për DPQ dhe TCB, çka krijon avantazh dhe kursim në kohë.

Marrëdhëniet me publik dhe komunitete


Përveç aktiviteteve të veta të rregullta, KEK gjatë vitit 2023, ka pasur edhe një komunikim intensiv me publikun dhe institucionet vendore e ndërkombëtare.

- Lidhur me këtë, janë mbajtur kontaktet e vazhdueshme me të gjitha mediat, janë dërguar të gjitha përgjigjet në pyetjet e parashtruara si dhe ishin lëshuar rregullisht njoftime për publik për aktivitetet kryesore të korporatës. Gjatë vitit 2023, kanë qenë rreth 1000 përgjigje me shkrim/tel. në pyetje, prononcime mediatike si dhe paraqitje publike.
- Gjatë vitit të kaluar, fokus të lartë mediatik vazhdoi të kishte kriza energjetike globale pasojat e se cilës ishin reflektuar edhe në vendin tonë. Përkundër shume sfidave, u qartësua dhe u transmetua fakti se KEK kishte realizuar prodhimin në përputhje me planin dhe obligimet kontraktuale që ka, ndërsa mungesat në furnizim të konsumatorëve kishin të bënin me subjekte tjera jashtë kompetencave të KEK-ut.
- Për më tepër, është sqaruar edhe fakti se përtej obligimeve të prodhimit, me qëllim të tejkalimit të krizës energjetike, KEK kishte marr përgjegjësi shtesë duke depozituar një sasi nga tepricat e natës në KESH sasi kjo që iu kthye KEK-ut në kohën kur vendi ynë kishte nevojë, pra me këtë u krijua stabilitet energjetik dhe tejkalim i situatës së krizës edhe gjatë muajve të ftohet të sezonit dimëror kur konsumi në vend shënojë rritje.
- Gjatë vitit 2023 është transmetuar te opinioni dhe institucionet vendore e ndërkombëtare edhe përkushtimi i KEK-ut për të realizuar projektin investiv të delatimeve në njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B, projekt ky që do të mundësoi fillimin e punimeve për ndërhyrje investive për zvogëlim e oksideve të azotit (de-NOx) në të dy njësitë (B1 dhe B2) nga fondet IPA të Bashkimit Evropian. Opinioni është njoftuar edhe për remontet e rregullta vjetore në të gjitha njësitë prodhuese para sezonit dimërorë me qëllim të ngritjes së sigurisë së operimeve.

- Një temë tjetër mediatike gjatë vitit 2023 ka vazhduar të jetë edhe energjia e ri-përtëritshme, projekti i KEK me KFW dhe EIB për ndërtimin e parkut solar 100 MW/h në ish deponin e hirit të Termocentralit Kosova-A. Lidhur me këtë projekt, janë mbajtur debate publike dhe jemi pajisur me pëlqime e nevojshme nga komuna dhe MMPHI. Temë tjetër ka qenë edhe përfundimi i brezit të gjelbër në trasenë nga IMP (ambulanta) deri në hyrje të Obiliqit dhe marrëveshja për vazhdimin e trasesë nga IMP në drejtim të hyrjes 01.
- Bazuar në ligjin për qasje ne dokumentet publike, KEK ka trajtuar të gjitha kërkesat e kësaj natyre dhe është përgjigjur pozitivisht duke ofruar qasje në dokumentet publike (përveç disa kërkesave të cilave i është dhënë qasje e pjesshme) për arsye se lëndët kanë qenë në proces e sipër, si dhe kemi marrë pjesë në të gjitha seancat e thirrura nga Agjencioni për Informim dhe Privatësi.
- Gjatë kësaj periudhe, kane vazhduar brengat e shprehura publikisht nga banorët dhe komuna, të përcjella edhe nga mediat, në lidhje me ankesat e qytetarëve rreth gjendjes mjedisore si pasojë e operimeve tona ditore. Në këtë drejtim fal koordinimit të veprimeve me divizionet prodhuese rreth çfarëdo problematike të mundshme (si startimi/ndalja e bllokut, puna elektro-filtrit nga ndonjëri TC, apo ndonjë problematike në DPQ) që mund të ndikoi tek banorët, kemi arritur të njoftojmë palët e interesit me kohë dhe të evitojmë keq interpretimet e mundshme eventuale.
- Gjatë vitit 2023 janë aranzhuar edhe shumë vizita të institucioneve vendore e ndërkombëtare, të krerëve të shtetit, vizita studentore si dhe vizita të rregullta të KFOR-it me theks të veçantë atij Britanik, Gjerman dhe Zvicëran. Në këtë drejtim, në bashkërendim me ambasadat e huaja me mision në Kosovë kemi aranzhuar edhe vizita të dhjetëra kompanive ndërkombëtare të interesuara në aktivitetet dhe operimet e KEK-ut.
- KEK ka marrë pjesë dhe ka qenë sponsor gjeneral në konferencën e II ndërkombëtare të organizuar nga CIGRE – Kosovë. Në konferencë kanë qenë pjese e paneleve disa zyrtarë të lartë të korporatës, janë prezantuar disa punime shkencore dhe për 60 min. është prezantuar puna, projektet, sfidat dhe objektivat e korporatës.
- Gjatë vitit 2023 janë trajtuar edhe temat që ndërlidhen me projektet afatgjata si: Modernizimi i Turbinave në TC-B dhe Projektet e financuara nga BE si, Projekti për pastrimin e ujërave të ndotura në TC Kosova B dhe Projekti i Elektro-filtrave dhe DeNOx-it. Bazuar ne informatën nga Zyra e BE-ë në Kosove, kemi sqaruar se gjatë vitit 2025 pritet të realizohet projekti për ndërtimin e Fundërruesit Elektrostatik të ri (Elektrofiltrit) dhe impiantit te de-NOx ne njësinë B2 dhe në vitin 2026 në njësinë B1. Si rezultat i kësaj shkarkimet e PM dhe NOx në TC Kosova B pritet të jenë në përputhje me kufijtë e lejuar për vitin 2027.

Burimet Njerëzore

Nisur nga të dhënat e departamentit të Burimeve njerëzore, si dhe dukje qenë si detyrim për të garantuar vazhdimësinë e operimit me njësite qenësore dhe sigurimin e prodhimit si sfiduese për korporatën gjatë vitit 2023 dhe në vijim mbetet rifreskimi stafit dhe kryesisht atij me përgatitje të mesme dhe superiore




teknike. Bazuar në këto të dhëna, korporata ka filluar vitin 2023 me 3436 dhe e ka mbyllur me 3341 punëtorë (apo 95 punëtorë më pakë). Pavarësisht se gjatë vitit 2023 janë angazhuar përmes procedurave rreth 181 punëtorë të rinj, numri total i të punësuarve të rregullt, është zvogëluar ndjeshëm në fund të vitit. Kjo për faktin se 235 punonjës kanë përfunduar

kontratën me KEK si rrjedhojë e pensionimi, 18 punëtorë të KEK-ut kanë vdekur para moshës së pensionimit, por asnjë nga shkaktaret e lidhur me aksidente në punë. Gjatë vitit kishte 8 ndërprerje vullnetare të marrëdhënies së punës si dhe 2 shkëputje të kontratave nga masat disiplinore, dhe 4 pushime pa pagesë.

Prandaj, në bazë të nevojave të korporatës, trendëve të kaluara në ndryshimin e numrit të stafit dhe në përputhje me qëllimet e korporatës të cilat janë buxhetuar në vitin 2024 do të vazhdohet me procese të reja të rekrutimit të stafit.

Qendra e trajnimeve e cila operon në kuadër të KEK, zhvillon trajnime sipas planit dhe me kërkesë të njësisë operuese dhe të administratës së KEK. Por qendra kryen edhe trajnime sipas kërkesave për operatorë të jashtëm. Gjatë vitit, janë zhvilluar programe të ndryshme trajnime për 432 persona (prej tyre 50 jashtë KEK) si dhe gjithsej 1563 ditë trajnim (prej tyre 268 ditë trajnim për personat jashtë KEK-ut).



Lëndë e trajnimeve ishin fusha të ndryshme duke përfshirë: sigurisë në punë, teknologji elektrike, teknologji mekanike dhe atë të saldimit, teknologjinë e xehetarisë, teknologji informative si dhe menaxhim dhe administrim. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm i përmbyllur gjatë 2023 është edhe kontraktimi i shërbimit të sigurimit shëndetësor me afat për 36 muaj, duke filluar nga 01 Janar 2024.

Gjatë vitit 2023, janë shqiptuar gjithsej 6 vërejtje me goje dhe 49 vërejtje me shkrim, 9 raste të suspendimit të përkohshëm nga puna pa pagesë (si masa disiplinore) dhe 6 raste të shkëputjes së kontratës së punës si pasoje e shkeljeve të detyrave të punës.

Departamenti i Mjedisit

Gjate kësaj periudhe, ishin përgatitur dhe dërguar rregullisht në MMPHI dhe Komune të Obiliqit raportet periodike mujore dhe vjetore, ku janë përfshirë të dhënat bazë që rezultojnë nga monitorimi i mjedisit, si dhe janë paraqitur çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në KEK. Me këtë rast, aty janë paraqitur shënimet monitoruese integrale të tere sistemit, duke filluar nga lënda e parë, prodhimi dhe shfrytëzimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike dhe efektet në mjedis

Kane vazhduar aktivitetet në terren rreth inspektimeve të rregullta që kanë të bëjnë me çështje mjedisore në njësi prodhuese brenda KEK-ut.

Ne ndërkohë, është angazhuar në procesin e ndjekjes së veprimeve për finalizimin e Lejes Mjedisore të Integruar (LMI). Aplikacioni është dorëzuar në fillimi të muajit nëntor në MMPHI dhe është trajtuar. Gjate vitit 2024 pritet të ketë përgjigje zyrtare dhe ndërkohë që KEK-u duhet për jete i përgatitur për veprime konkrete për përmirësimet e kërkuara ligjore në mjedis. Ne ndërkohë në kuadër të menaxhmentit të KEK është formuar një grup ekspertesh për të ndihmuar në këtë proces.

Rezultatet e monitorimit të emisioneve (shkarkimeve) të pluhurit dhe gazrave nga Termocentralet, për 2023 janë të paraqitura me poshtë:

Muaj i	Përlogaritja e emisioneve për vitin 2023						
	Bruto gjenerimi i realizuar i EE [MWh]	Thëngjilli i shpenzuar [t]	Prodhimi i hirit (t) Mes.0.23(t /Mw)	SO ₂ [kg] Mes. 2.67 [kg/MWh]	NO _x [kg] Mes.3.04 [kg/MWh]	CO ₂ [kg] Mes. 1328 [kg/MWh]	Emis.Grimcave te pluhurit(kg) Mes.0.24(kg/M Wh)
TCA	2,290,512	3,493,044	526,818	6,115,668	6,963,157	3,041,800,334	549,723
TCB	3,243,685	3,944,408	583,863	6,600,900	8,141,651	3,506,424,008	4,314,102

* Vlerat e lejuara: Pluhur <50; SO₂ <400; NO_x < 500


Siguria Fizike dhe të tjera

Sektori i sigurisë fizike mbulon këtë aktivitet përmes shërbimeve të kontraktuara me operator të jashtëm të licencuar, sipas kërkesave ligjore për sigurimin fizik të objekteve dhe hapësirave. Shpallja për blerjen e shërbimeve të sigurisë fizike për periudhë 12-mujore është pezulluar nga Organi Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), sipas ankesës, dhe aktualisht nuk ka një kontratë afatgjatë. Vlen të theksohet rëndësia e kësaj kontrate për KEK është e padiskutueshme kur dihet se operimet dhe asetet e korporatës kanë një shtrirje një territor të gjerë, ato përfshijnë rreth 4,500 hektar. Këtu përfshihen mihja sipërfaqësore, me të gjitha objektet dhe infrastrukturën tjetër (shiritat transportues, mekanizimi ndihmës, sistemi shiritave, rrejtji elektrik dhe ekskavatorët), Termocentralet Kosova A dhe Kosova B, si dhe hapësira të mëdha të objekteve që nuk janë tashmë në funksion.

Divizioni i teknologjisë Informative ka qene i angazhuar ne zhvillimin e aplikacioneve për rekrutim, i cili është testuar dhe zbatuar e sukses ne testimin e kandidateve për procedura rekrutimi dhe për tregtim te energjisë. Mirëmbajtja e rrjetit dhe pajisjeve ka qene e rregullt.

Performanca Operative dhe Indikatorët kyç të Performancës

Përkundër vështirësive në realizimin e prodhimit, për shkak të mungesave të shumta si mungesa e punëtorëve, mos realizimi i plotë i investimeve kapitale dhe ndikimit që kishin krizat e fundit në realizimin e planeve të veta afatgjatë, si dhe operimi me pajisje të vjetra në të tri divizionet kryesore të prodhimit, KEK vazhdon që optimalisht të realizoj planet e veta të prodhimit të aprovuara në BVEE vjetore. Megjithëse, nën kushte të pasigurisë së madhe për stabilitetin e operimeve, edhe për shkak të arsyeve të mësipërme por edhe nga mos realizimi i buxhetit të vet sipas planifikimit, KEK ka realizuar një nivel më të ulët të



prodhimit krahasuar me vitin paraprak. Kjo shihet nga tabela e mëposhtme, ku prodhimi i thëngjillit në vitin 2023 ishte 6.9 milion ton, ose për 17% më i vogël se në vitin 2022. Ndërsa prodhimi i energjisë elektrike, në 2023 bazuar edhe në bilancin energjetik për shkak të ndalesave të planifikuara për investimet

afatgjata në dilatimet dhe investimet në remontet e blloqeve të TCA, ishte 4.9 GWh, ndjeshëm më i vogël se në vitin 2022, me 13.2%.

Prodhimi KEK ShA	Energjia në MWh		Variacioni në % '23 vs '22		Thëngjilli në ton		Variacioni në % '23 vs '22	
	2023	2022	2021	'22	2023	2022		2021
Realizimi Neto	4,930,737	5,677,896	5,769,929	-13.2%	6,923,659	8,344,548	8,535,437	-17.0%

KEK e mat dhe e raporton performancën e vet vjetore përmes Indikatorëve Kyç të Performancës, të cilët raportohen nga divizionet e korporatës në Bordin e Drejtorëve për aprovim. IKP raportohen për: financat, zyra ligjore, burimet njerëzore dhe shërbimet e korporatës, ofrojnë informata në bazë periodike, që i shërbejnë Menaxhmentit dhe Bordit lidhur me marrjen e vendimeve të tanishme dhe vendime strategjike për të ardhmen e Korporatës.

Divizioni i Prodhimit të Qymyrit


Roli i Divizionit të prodhimit të qymyrit është furnizimi i vazhdueshëm i termocentraleve me qymyr në sasi dhe cilësi në bazë të kapaciteteve të pajisjeve ekzistuese, duke synuar kosto sa më të ulët të operimit dhe në ngritje të produktivitetit të prodhimit, në respektimin e bazës ligjore dhe rregulloreve në fuqi për sigurinë e minierës, personelit dhe pajisjeve të DPQ-it.

Divizioni i Prodhimit të Qymyrit ka pasur një performancë optimale gjatë vitit 2023 në ofrimin e pandërprerë të termocentraleve me thëngjill. Megjithatë me një rënie në prodhim, e shkaktuar nga faktorë të operimeve dhe nga kërkesa më e vogël me bilanc të energjisë, kishte një rënie prej 16.6% në raport me planin e prodhimit të qymyrit dhe për 29.1 % nën targetet e planifikuara të prodhimit të djerrinës. Ngecjet e prodhimit janë shkaktuar edhe për shkak të disa vështirësive në realizimin e planit të shpronësimeve dhe zhvendosjes së minierës.

Indikatori Kyç i Performancës	Njësi	2023			2022		Variacioni ne (%)
		Plani	Realizimi	Variacioni ne (%)	Plani	Realizimi	
Sibovci J.P.							
<i>Prodhimi i Qymyrit</i>	ton	8,300,000	6,923,659	-16.6%	8,782,000	8,344,548	-5.0%
<i>Prodhimi i Djerrinës</i>	m ³	14,533,000	10,308,666	-29.1%	13,500,000	9,692,074	-28.2%

Trendi i realizimit të planit të prodhimit në DPQ është i ndikuar edhe nga kërkesa e TC-ve sipas nevojave të operimit të tyre. Po ashtu, pavarësisht këtyre kërkesave KEK nuk ka arritur të realizoj planet e veta për shitjen e qymyrit për treg të jashtëm me projeksione deri mbi 1 milion ton, gjatë vitit 2023.

Tabela. Realizimi Divizioni i Mihjeve 2018-2023



Pavarësisht se DPQ përballlet me një situatë më të vështirë, si rrjedhojë e sfidave dhe pengesat janë bërë edhe më të rënda në lidhje me problemet në zhvendosjen dhe shpronësimin e tokave për zgjerimin e minierës, mungesën e vazhdueshme të personelit, si dhe vonesat në realizimin e planeve të investimeve. Kjo dhe zbatimet rigoroze të procedurave operative, mund të eliminojnë tronditjet serioze në funksionimin e proceseve të prodhimit dhe në sigurinë e minierës, me qëllim që të garantohet stabiliteti i prodhimit të thëngjillit dhe rrjedhimisht energjisë elektrike.

Divizionet e Prodhimit të Energjisë Elektrike

KEK ka si aktivitet të saj kryesor prodhimin e energjisë të cilin e realizon përmes dy termocentraleve të veta të ndara në divizione TCA dhe TCB-se. Termocentralet Kosova A përmbajnë 5 Njësi Punuese, prej tyre tri njësi janë aktive të ndara në blloqe A-3, A-4, A-5 dhe Termocentralet Kosova B me 2 njësi Punuese B-1 dhe B-2.

Planifikimi dhe raportimi për aktivitetin vjetor brenda vitit, për prodhimin e energjisë për njësitë gjeneruese të termocentraleve, bëhet me anë të tre Indikatorët kyç të performancës, që janë: 1. disponueshmëria kohore, 2. gjenerimi bruto dhe 3. gjenerimi neto i prodhimit të energjisë elektrike të cilët janë treguesit kryesor matës dhe monitorues të krahasimit mes planit dhe realizimit të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike aprovuar për vitin 2023. Këta indikatorë rishikohen në bazë të statusit operativ dhe bilanci mund të rishikohet për çka njoftohen palët dhe institucionet përgjegjëse. Në bazë të bilancit elektroenergetik të aprovuar për vitin 2023, koeficienti i gatishmërisë funksionale të gjeneratorëve të aplikuar për Termocentralin Kosova B për Blloqe, për B-1 ka qenë 67%, për B-2 ka qenë 70.5%, ndërsa për Termocentralin Kosova A për Blloqe, A-3 është 61.7%, për A-4 është 75.5%, për A-5 është 51.7 %.

Sa i përket IKP-së të gjenerimit bruto të energjisë elektrike për vitin ka qenë 3,243,685 MWh për TCB ndërsa për TCA sasia e gjenerimit bruto ishte 2,290,518 MWh.

Disponueshmëria kohore	Njësia	Viti 2023		(%) e realiz.	Viti 2022		(%) e realiz.
		Plani	Realizimi		Plani	Realizimi	
A3	%	79.7	61.7	77%	69.2	67.6	98%
A4	%	81.6	75.5	93%	77.2	79.4	103%
A5	%	59.4	51.7	87%	38.4	41.4	108%
B1	%	69.6	67%	96%	86.5	88.9	103%
B2	%	71	70.5%	99%	80.8	83.3	103%
Gjenerimi Bruto							
Kosova A	MW/h	2,807,048	2,290,512	82%	2,485,004	2,295,488	92%
Kosova B	MW/h	3,318,893	3,243,685	98%	4,104,707	4,050,905	99%
TOTALI (Kosova A + B)	MW/h	6,125,941	5,534,197	90.3%	6,589,711	6,346,394	96%
Gjenerimi Neto							
Kosova A	MW/h	2,437,080	2,009,518	82%	2,186,695	2,020,346	92%
Kosova B	MW/h	3,000,264	2,921,228	97%	3,710,637	3,657,549	99%
TOTALI (Kosova A + B)	MW/h	5,437,344	4,930,746	91%	5,897,333	5,677,896	96%


Tabela- Divizioni TCA dhe TCB 2022-2023

Gjatë vitit 2023 me gjithë vështirësitë dhe ndryshimet e shpeshta në BVEE si rrjedhojë e ndryshimeve në planin vjetor dhe për realizimin në kohë të remonteve, gjenerimi neto në raport me planifikimet ishte 91% në total për KEK. Ndërsa sipas njësive përmbushje të planit të prodhimit për 82 % në TCA de 97% në TCB.. Në këtë rezultat, ndikim kishte edhe ndalesa, sipas balancës vjetore fillestare të aprovuar (BVEE2023), Ndalesa për remont kapital të njësive A5 ka zgjatur për 4 muajt e parët të vitit. Pastaj ndalesat e bllokut A4 në fund të vitit 2023. Nga ana tjetër, TC Kosova B – Remonti (delatimet) i B1 ka filluar sipas planifikimit me datën 25 korrik dhe ka zgjatur deri më 24.10.2023, duke bërë që prodhimi i energjisë elektrike të jetë i diktuar nga plani dhe efikasiteti i realizimit të investimeve kapitale dhe mbajtja sa më shkurt jashtë pune të njësive në rast të ndodhjes së ndërprerjeve të paplanifikuara të prodhimit, për shkak të gjendjes së pajisjeve të vjetruara.

Performanca Financiare



Pavarësisht sfidave të vazhdueshme që e shoqërojnë në vazhdimësi, por edhe duke u përballur me efektet e periudhës pas krizave, edhe në vitin 2023 KEK ka treguar stabilitet në aspektin financiar. Duke pasur edhe këtë vit një vazhdimësi me performancë financiare pozitive. Megjithatë dukshëm më të ulët se ajo e vitit 2022, KEK realizoj një fitim neto prej €12.9 milion në vitin 2023, që përbën një rënie të fitimit neto për € €92.3 milion krahasuar me vitin 2022. I cili fitim ishte kryesisht si rrjedhojë e çmimeve tejet të larta të energjisë elektrike të eksportuar gjatë periudhës së krizës (kujtojmë që energjia e eksportuar ishte kryesisht energji e tepricave nga kërkesat e palëve kontraktuese. Gjithashtu njësitet e B1/B2 gjatë vitit kane punuar

me pak për shkak të remonteve kapitale (projekti i dilatimeve). Edhe nga grafiku më poshtë shihet ndikimi i të hyrave të përgjithshme varet nga sasia e energjisë në dispozicion e cila në total ishte më e vogël se vitin e kaluar me 8.5% si rrjedhojë e remonteve kapitale në njësitë gjeneruese të KEK. Ndërsa vetëm për eksport ndryshimi në sasi ishte po ashtu negativ me një rënie prej 230.2 mijë MWh ose më i vogël se viti 2022 me -39.6%. megjithëse energjia e eksportuar mban primatin për nga niveli i çmimit me një mesatare prej 74.2€/MWh ai ishte më i ulët se mesatarja vjetore e çmimeve të eksporti të 2022 e cila ishte 202.2 €/MWh. Këta dy faktorë kanë ndikuar ndjeshëm që niveli i përgjithshëm i të hyrave në vitin 2023 të jetë më i ulët për 36% krahasuar me vitin 2022. Prandaj, këto rezultate tregojnë rëndësinë dhe efektin e drejtpërdrejtë që realizimi i planeve investive për rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe stabilitetit të prodhimit nga njësitë gjeneruese, ka në rezultatin financiar të korporatës.



KEK gjatë vitit 2023, përkundër realizimit të një sërë investimesh kapitale me rëndësi të jashtëzakonshme për operimin e njësive, si rezultat shtyrjes së projekteve të ndërlydhura me investimet nga donacionet e BE, si dhe për shkak të efekteve të krizave të fundit (pandemisë dhe krizës energjetike), KEK ka ndryshuar disa herë nga planifikimi Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike (BVEE), i cili ka rezultuar me ndryshime në planin e ndalesave të njësive gjeneruese duke zvogëluar daljet e parasë për investimet e planifikuara. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kishte investime në depozita afatgjatë bankare dhe letra me vlerë, duke rritur portofolion e investimeve financiare. Po ashtu, gjatë 2023 KEK ka vazhduar me shlyerjen e obligimeve të veta rrjedhëse duke ndikuar në rritjen e nivelit të kapitalit punues neto.


Raportet e performacës	2023	2022	2021	2020	2019
Qarkullimi i aseteve	0.33	0.59	0.51	0.46	0.44
Margjina e fitimit neto	6.4%	34 %	17.3%	12.3 %	10.4 %



EBITDA, e kalkuluar si fitimi para interesit-tatimeve –zhvlerësimit dhe amortizimit dhe eliminimit të efekteve të zërave jomonetar në pasqyrën e të ardhurave. Si e tillë, ajo përdoret për të shfaqur performancën financiare të korporatës, e që mat të ardhurat me bazë të parasë së gatshme nga operacionet e vazhdueshme pa llogaritur strukturën e saj të kapitalit, politikën e taksave dhe politikat kontabël lidhur me zhvlerësimin e asetëve. EBITDA është indikator i mirë i aftësisë paguese para të gatshme të KEK dhe shfaq aftësinë e korporatës për të investuar në zëvendësimin e asetëve dhe në zgjerim biznesi. EBITDA, është një tregues i mirë i performancës dhe tregues i fekteve direkte të biznesit. Ajo në vitin 2023 kishte një rënie të ndjeshme për arsyet e përmendura më lartë tek rënia e të hyrave dhe kap vlerën e €64.2 milion. Vlera e kalkuluar e EBITDA për 2022 ishte €165 milion.

Po ashtu, indikatorë i rëndësishëm që mat vlerën e kthimit të aksionarit në kompani, është përdorur qarkullimi i asetëve. Si rezultat i zvogëlimit të vlerës së asetëve mesatare dhe uljes së ndjeshme të të hyrave, ka një rënie në vlerën e këtij indikator si tregues efikasiteti të kompanisë në përdorimin e asetëve të veta për të gjeneruar të hyra në të ardhmen. Kjo shihet nga grafiku ku qarkullimi i asetëve mesatare nga 0.59 në vitin 2022, ka rënë në 0.33 në vitin 2023.

Për më tepër, efekti i rënies së të hyrave shihet edhe në margjinën e fitimit neto. Megjithatë, KEK vazhdon të ketë performancë pozitive vjetore, trendët luhatëse të realizimit të fitimit neto ndikojnë në kualitetin e fitimeve, megjithatë i ndikuar nga efekteve të krizave. Grafiku i marxhinës së fitimit neto (e matur si raport i fitimit neto ndaj të hyrave) ka një trend konstant pozitiv gjatë viteve. Në vitin 2022 është rritur në 34% nga 17.3% sa ishte në vitin 2021, për të rënë në 6.4 % në vitin 2023. Kjo rënie i atribuohet efekteve të zvogëlimit të diferencës mes të hyrave dhe shpenzimeve vjetore, por edhe nga ndikimet e të hyrave dhe shpenzimeve jo të përhershme të cilat nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë. Prandaj, është e rëndësishme që KEK mund ta kompensojë këtë nivelin e rënies së të hyrave të hyrave me shitjen e thëngjillit dhe të shqyrtoj mundësinë e negociimit të çmimeve më të favorshme për shitjen e energjisë brenda vendit.



Raporti përfshin edhe faktorët rastësor të shpenzimeve dhe të hyrave jo të vazhdueshme të cilat për shkak të situatave dhe ngjarjeve të jashtme, natyrës së biznesit, vjetërsisë së aseteve krijojnë të hyra dhe shpenzime të jashtëzakonshme (siç ishte rasti me dënimin nga ZRRE, obligimet për import të energjisë si pasojë e rënieve të paplanifikuara të njërive të prodhimit, konteste të ndryshme ligjore etj.) ose edhe ngarkesa financiare që mund të ndikojnë në paraqitje jo afatgjatë të trendëve në fitimin e periudhës.

Pasqyra e të ardhurave

Të hyrat e korporatës të realizuara nga veprimtaria gjatë vitit 2023 janë në shumë €180.8 milion. Të hyrat janë më të vogla krahasuar me planifikimin e KEK dhe më të vogla se viti paraprak me €102.7 milion ose 36% , duke reflektuar shkaktarët (tashmë të diskutuara në këtë raport), ndryshimet në çmimeve në tregjet e energjisë elektrike si dhe me realizimin më të ulët të prodhimit më pak se plani dhe ndikuar nga periudha e ndalesave të njërive gjeneruese, për realizimin e projekteve kapitale të remonteve si dhe për projektin e dilatimeve. Këto kanë bërë që të bie disponueshmëria e njërive gjeneruese për prodhim të energjisë gjatë vitit. Kjo situatë ka rezultuar me një fitim neto, i prezantuar në pasqyra financiare, në shumë € 12.9 milion ose € 92.3 milion më pak krahasuar me fitimin e vitit paraprak (viti 2022: €104.6 milion).

(në EUR 000)	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022	≠ në vlerë	≠ në %
Shitja e energjisë				
Të hyra nga shitja e energjisë	141,139	150,622	(9,483)	-6%
Të hyra nga jo-balanca	3,890	10,537	(6,647)	-63%
Të hyrat nga ko gjenerimi	1,589	1,402	187	13%
Të hyrat nga faturimi i energjise elektrike	2,516	-	-	-
Eksporti i Energjisë *	26,009	117,386	(91,377)	-78%
	175,143	279,947	(104,804)	-37%
Shitjet tjera				
Shitja e thëngjillit	5,399	3,260	2,139	66%
tjera	282	310	(28)	-9%
	5,681	3,570	2,111	59%
Gjithsej të hyra nga veprimtaria	180,824	283,517	(102,693)	-36%

Duke analizuar në mënyrë horizontale, dallimet mes periudhave në zëra të veçantë të të hyrave nga veprimtaria janë paraqitur në tabelën më poshtë:

*Tek eksporti i energjisë përfshihet edhe shkëmbimi i energjisë me KESH SHA. KEK ka filluar eksportin e energjisë më 31 maj 2019. Para kësaj date eksporti është realizuar nga KESCO për llogari të KEK.

- Viti 2022 u karakterizua me të hyrat rekorde nga veprimtaria e KEK në vlerë € 283.5 milion. Duke qenë një vit i jashtëzakonshëm dhe i ndikuar nga faktorë jo të përhershëm të hyrat e vitit raportues nuk mund të shërbejnë për një krahasim të drejtë për trendët e ardhshme. *Megjithatë, sasia e energjisë së prodhuar ishte për 13.2% më e ulët (2023: 4.93 milion MWh; 2022: 5.68 milion MWh energji elektrike) Ndryshimi kryesor në rënien e të hyrave nëse abstrahojmë analizën e sasisë, vie nga rënia e çmimeve të energjisë për eksport. Kjo ka shkaktuar rënie të të hyrave nga eksporti i energjisë elektrike me €91.4 milion ose 78% më të ulëta se në vitin 2022.*
- *Në vijim të argumentit të njëjtë, vlerën e të hyrave nga eksporti i energjisë e ka ndikuar çmimi mesatar i energjisë së eksportuar. Si mesatare gjatë vitit 2023 stabiliteti i çmimeve në përgjithësi u shoqërua edhe me rënien e çmimeve të energjisë në bursa, e cila ndikoi në çmimin mesatar në bazë vjetore i energjisë të jetë më i ulët në 74.2 €/MWh (2022: 202.2€/MWh). Kjo e shoqëruar me sasinë e energjisë për eksport më të vogla për 40% në 2023 krahasuar me vitin paraprak (2023: 350.4 mijë MW/h; 2022: 580.7 mijë MWh), ndikoj që të hyrat e realizuara nga eksporti gjatë vitit 2023 të jenë më të vogla.*
- Gjatë vitit 2023, shitjet e energjisë në vend ishin më të vogla për 6% ose në vlerë € 9.4 milion më të vogla se në vitin 2022. Në këtë ndryshim ndikim kishte sasia e energjisë në dispozicion për nominimet sipas marrëveshjeve ekzistuese.
- Edhe gjatë vitit 2023, KEK ka mbajtur të pandryshuara çmimin e energjisë për blerësit vendor, për të mos ndikuar në çmimet e konsumatorëve fundor në kohën kur vendi po ballafaqohet me probleme ekonomike të shkaktuara nga inflacioni i lartë, si rrjedhojë e pandemisë dhe krizës energjetike. Çmimet e energjisë për furnizim me shumicë për shërbim universal (USS) si dhe ato për mbulimin e humbjeve u mbajtën të pandryshuara: 29.5€/MWh dhe 36€/MWh respektivisht.
- Të hyrat nga grantet janë realizuar këtë vit në shumë prej € 2.2 milionë sipas shkallës së zhvlerësimit të aseteve me të cilat janë të lidhura grantet e dhëna nga viti 2010, viti i fundit kur KEK ka përfituar grantet nga qeveria, për investime kapitale si dhe grantet e realizuara për importin e energjisë elektrike gjatë vitit.
- Me shfaqjen e krizës energjetike dhe me shpalljen e gjendjes emergjente si pasojë e Krizës

energjetike, Qeveria e Republikës së Kosovës si aksionare i ndau KEK-ut subvencione për mbulimin e diferencës në çmimin e importit të energjisë elektrike për pjesën e çmimit për USS mbi normën e pranuar nga ZRRE për furnizuesin publik. Gjatë vitit 2023, janë njohur në të hyra pjesa e subvencionuar për importin e energjisë në vlerë rreth € 9.4 milion, në kategorinë e granteve. KEK ka importuar edhe për mbulimin e detyrimeve të veta sipas rregullave të tregut. Prandaj, në vlerën e përgjithshme të shpenzimeve të importit të energjisë elektrike përfshihet edhe pjesa e njohur në të hyra nga faturimet për këtë qëllim, bazuar nga marrëveshja e monitorimit mes KEK dhe Ministrisë së Ekonomisë të vitit 2022.

- Të hyrat tjera në vitin 2023, janë për 59% më të larta se viti paraprak, ose në vlerë prej €2.1 milion. Ndikim më të madh në këtë kategori kishte realizimi i kontratës për shitjen e thëngjillit e cila u realizua me çmime dhe kushte të favorshme për KEK.

Pasqyra e shpenzimeve

Shpenzimet operative të vitit 2023 ishin €179.8 milion, për € 11.08 milion ose 6% më të vogla se në vitin 2022. Në këto shpenzime përfshihen edhe vlerësime kontabël dhe/ose shpenzime të njehershme (jo të vazhdueshme si gjobat dhe ndëshkimet), si psh. importi i energjisë elektrike. Më poshtë, paraqitet në mënyrë tabelore struktura e shpenzimeve sipas pjesëmarrjes si dhe krahasuar me vitin paraprak:



Shpenzimet operative	2023	2022	≠ në vlerë	≠ në %
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(47,808)	(48,462)	654	-1%
Shpenzimet e personelit	(48,033)	(47,027)	(1,006)	2%
Energjia elektrike dhe komunalit	(37,595)	(53,025)	15,430	-29%
Kostot e mirëmbajtjes	(2,902)	(3,888)	986	-25%
Materialet dhe furnizimet	(7,316)	(4,963)	(2,353)	47%
Shpenzimet e linjtit	(21,225)	(25,071)	3,846	-15%
Provizionet për shlyerjen e inventarit	3,122	(216)	3,338	-
Humbjet nga zhvlerësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera	(972)	(4,500)	3,528	-78%
Ndryshimi në provizione	(3,454)	423	(3,877)	-917%
Shpenzimet e shtyera të prodhimit të energjisë	(3,922)	2,367	(6,289)	-266%
Shpenzimet e tjera operative	(9,727)	(6,551)	(3,176)	48%
Gjithsej	-179,832	-190,913	11,081	-6%

Lëvizjet më të mëdha në shpenzimet:

- Zvogëlim i shpenzimeve të zhvlerësimit dhe amortizimit me 1%. KEK në baza periodike bën vlerësimin e jetëgjatësisë së aseteve, dhe vlera e shpenzimeve të zhvlerësimit është e ndikuara ndër të tjera edhe nga rivlerësimi i jetëgjatësisë së aseteve ekzistuese të KEK, duke zvogëluar vlerën e aseteve.
- Shpenzimet e personelit në vitin 2023 ishin për €1 milion, ose për 2% më të larta krahasuar me vitin

2022. Kjo, përkundër faktit se kishte një rënie të numrit të punonjësve nga 3436 sa ishte në fillim të vitit u zvogëluar në 3341 në fund të vitit 2023. Në rritjen e shpenzimeve të personelit gjatë vitit 2023, ndikim kishin numri i punësimeve të reja ishte 181, numri të pensionuarve ishte 235 të cilët përfitojnë pagesa me rastin e pensionimit sipas të drejtave ligjore. Po ashtu, në shpenzimet e personelit janë përfshirë edhe shpërblimi prej 500€ për punëtorë, për performancën e lartë të korporatës në vitin 2022, sipas vendimit të BtD.

- Shpenzimet e materialit dhe furnizimet në 2023 janë në vlerë € 7.3 milion, dhe janë më të larta krahasuar me vitin paraprak me 47%. Kjo si rrjedhojë e investimeve në remonte dhe në investime tjera kapitale ndikojnë në rritjen edhe të kësaj kategorie.
- Ndërlidhur me investimet edhe provizionet për shlyerjen e inventarit rezultojnë me vlerë pozitive duke pasqyruar, futjen në përdorim të inventarit të mbetur në dispozicion, dhe të njohur si shpenzime në periudhat e kaluara.
- KEK edhe gjatë vitit 2023 vazhdon të ketë vonesa në pagesën e faturave të veta rrjedhëse çka shkakton njohjen e provizioneve të Llogarive të Arkëtueshme. Megjithëse paraqitet me vlerë më të vogël këtë vit me vlerë prej € 0.97 milion. Kjo kategori e shpenzimeve ka të bëjë me vonesat në pagesën e faturave të rregullta nga KESCO dhe KEDS, të shkaktuara nga Pandemia Covid 19 dhe nga kriza energjetike. Për këto vonesa dhe për interesin e aplikuar sipas marrëveshjeve ekzistuese për shitblerjen e energjisë, sipas politikave të aprovuara kontabël janë njohur provizione në pasqyrën e të ardhurave të vitit.
- Shpenzimet për taksën e linjtit (tantiema) në vitin 2023 janë më të vogla se viti paraprak me €3.8 milion ose 15%, krahasuar me vitin 2022. Këto shpenzime janë të lidhura drejtpërdrejt me sasinë e prodhimit të thëngjillit nga ana e KEK.
- Shpenzimet tjera operative gjatë vitit 2023 janë më të larta për 48% ose €3.1 milion, krahasuar me vitin 2022, dhe reflektojnë kryesisht diferencën për gjobën nga ZRRE shqiptuar ndaj KEK sipas vendimit me kod. V_1738_2023.



- Shpenzimet e energjisë elektrike dhe komunalit, gjatë vitit 2023 janë më të vogla për €15.4 milion ose 29% krahasuar me vitin 2022. Këtu ndikim të madh kishin shpenzimet për import të energjisë elektrike nga fondet e subvencionit, të cilat janë më të vogla gjatë vitit, duke reflektuar stabilizimin e tregut të energjisë dhe efektet graduale të rimëkëmbjes në këtë sektor. Ky zë përfshinë shpenzimeve për blerjen e energjisë në bazë të obligimeve të marrëveshjes së subvencionit të Qeverisë së RKS për import të energjisë për USS. Po ashtu, ndikim në këto shpenzime kishte sasia më e vogël e prodhimit të energjisë elektrike ka shkaktuar uljen e shpenzimeve të transmisionit të energjisë në rrjetin e KOSTT.
- Shpenzimet e transmisionit të energjisë elektrike janë më të vogla për 33% krahasuar me vitin paraprak si rrjedhojë e sasisë së energjisë më të vogël të prodhuar nga KEK. Megjithatë, vlenë të theksohet se gjatë këto shpenzime viteve janë rritur për shkak të vendimit të ZRRE që nga muaji Tetor 2021 për ndryshimin me rreth 0.6 €për MWh të vendosur në rrjetin e KOSTT, si dhe të njëjtat janë ndryshuar sërish në TM 1 2022, duke i rritur kostot për KEK për rreth 28% ose në vlerë € 3.3 milion krahasuar me 2021, kosto e cila vazhdon të jetë e lartë megjithatë është e kalkuluar për njësi MWh të vendosur në rrjetin e KOSTT.

Energjia elektrike dhe komunalitë	2023	2022	± në vlerë	± në %
(në EUR '000)				
Karburanti	5,475	5,307	168	3%
Transmisioni i energjisë elektrike	10,192	15,102	-4,910	-33%
Importi I energjisë	8,255	4,556	3,699	81%
Shpenzimet për mbulimin e humbjeve (Vendimi i ZRRE-së 909_201	3518	3,518	-	-
Gaz dhe ujë	758	895	-137	-15%
Shkëmbimi i shpenzimeve të energjisë elektrike	-	-	-	-
Importimi i energjisë elektrike**	9,397	23,647	-14,250	-60%
	37,595	53,025	-15,430	-29%

- Shpenzimet tjera operative në vitin 2023 shpalosura në tabelën e mëposhtme, janë realizuar në shumë prej €9.7 milion apo 48 % më të larta se në vitin paraprak. Megjithëse, janë shpenzime jo të përhershme si gjopa e ZRRE, janë ndryshime që lidhen me aktivitetet operative të KEK. Rritje kanë edhe shpenzimet e sigurimit, ndërsa zbritjet janë në vlerë më të vogël dhe janë të pasqyruara në analizën horizontale të të dhënave në tabelën më poshtme, të krahasuara me vitin 2022.

Shpenzime të tjera operative	2023	2022	± në vlerë	± në %
(në EUR '000)				
Shpenzimet e sigurimit	2,338	1,925	413	21%
Shpenzimet gjyqësore	117	399	-282	-71%
Licencat	859	957	-98	-10%
Pagesat e dëmeve mjedisore	228	424	-	-
Shpenzimet jo të prodhimit	180	284	-104	-37%
Shlyerjet e PPE-së dhe inventarëve	65	98	-	-
Shërbime komunale	248	251	-3	-1%
Shpenzimet tatimore	702	159	543	342%
Ligjore dhe këshilluese	0	137	-137	-100%
Shërbimet e transportit	1154	1,195	-	-
Shpenzimet për gjoba dhe penalti	3,230	-	-	-
Shlyerjet e të arkëtueshmeve dhe pasurive të tjera	72	112	-	-
Shpenzimet tjera operative	534	610	-76	-12%
	9,727	6,551	3,176	48%

Në total, shpenzimet operative të KEK, kanë një trend të krahasueshëm vit pas viti, dhe pasqyrojnë aktivitetet e biznesit të KEK. Përjashtim bëjnë shpenzimet jo të vijueshme, të cilat vërehet një rritje e herëpashershme gjatë krahasimit të shpenzimeve në periudha të ndryshme. Si psh. shpenzimet për gjobat dhe penalltit, shpenzimet që lidhen me amortizimin e subvencioneve për importin e energjisë, shpenzimet e zhvlerësimit të aseteve pasqyrojnë edhe ndryshimet në vlerësimet kontabël si dhe në jetën e dobishme të mbetur të aseteve etj. Rritja e shpenzimeve ka pas edhe për kategoritë e shpenzimeve që lidhen me procesin e prodhimit, dhe që kanë një korrelacion të drejt me trendin dhe sasinë e prodhuar, shpenzimet e derivateve, taksa e çasjes në rrjetin e KOSTT etj.

Gjendja e Kompanisë

Me aktivitetet e saj, KEK gëzon një gjendje të mirë financiare, duke rritur vlerën e kapitalit të kompanisë në 63% megjithëse vlera e aseteve në kompani ka pasur një rritje prej 5% ose në vlerë neto prej €27.6 milion. Vlera total e aseteve më 31.12.2023 është € 604.3 milion (në 2022: €576.7).

Asetet Jo qarkulluese kapin vlerën e € 370.7 milion. Nga këto, pronat pajisje dhe impiantet janë rritur për 18% ose me €41 milion krahasuar me vitin 2022, si rrjedhojë e ndryshimit në vlerën neto të aseteve nga investimeve gjatë vitit. Ato paraqiten në vlerën neto të tyre, të rritur për vlerën e investimeve dhe zvogëluara për zhvlerësimin e vitit dhe refleksion i vlerësimeve kontabël të periudhës. Rritja e vlerës së aseteve në masë të madhe është shkaktuar nga ndryshimet që kanë ndodhur me rivlerësimin e tokave proces i filluar gjatë vitit dhe me efekt në pasqyrat e vitit 2023. Në vlerën e aseteve në fund të periudhës ndikim kishte zvogëlimi i depozitave me afat në është kompensuar me vlerën përafërsisht të njëjtë në

investime në letra me vlerë afatgjatë, duke rritur diversifikimin e portofolios për vitin 2023 dhe duke siguruar një kthim neto pozitiv në investimet financiare.

Paraja e gatshme në banka, megjithëse e zvogëluar për 50%, mbetet mjaftueshëm e lartë për të realizuar detyrimet rrjedhëse dhe operimet e kompanisë. Zvogëlimi i parasë së gatshme është si rrjedhojë e investimeve në depozita afatshkurtra në banka dhe në investime në letra me vlerë afatshkurtër duke rritur efektet pozitive në raport me paranë e mbajtur në llogari.

Inventari, është zvogëluar me 8% në përputhje me realizimin e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit.

Llogaritë e Arkëtueshme tregtare neto – kjo kategori ka rënie me 25% ose në vlerë €19.7 milion, duke reflektuar inkasimin e mjeteve nga blerësit e energjisë. Megjithatë, vlera e llogarive të arkëtueshme mbetet e lartë në €57.7 milion, dhe edhe gjatë vitit 2023 shpërfaq efektet e post krizave që krijojnë herë pas here situata të vështirësive për partnerët kryesor tregtar (KESCO dhe KEDS) në pagesën e faturave të energjisë elektrike.

Kjo gjendje ka filluar me shfaqjen e pandemisë gjatë vitit 2020, kur KEDS dhe KESCO kanë deklaruar vështirësi në inkasimin e mjeteve nga konsumatorët e tyre, duke u vonuar në pagesën e faturave sipas marrëveshjes për të cilën është ngarkuar me interes ndaj vonesës së pagesave. Marrëveshja parasheh aplikimin kamatave ndëshkuese për rastet e vonesave në pagesë dhe si të tilla nga ajo kohë, është rritur vlera e llogarive të arkëtueshme neto. Gjendja është përkeqësuar me krizën energjetike si rrjedhojë këto dy kompani kanë borxhe të pashlyera ndaj KEK. Megjithëse me ritme të ngadalta, gjendja ka filluar të përmirësohet gjatë vitit 2023.

	<u>2023</u>	<u>2022</u>	<u>≠ ne vlere</u>	<u>≠ ne %</u>
Të arkëtueshme tregtare:				
Te arketueshmet nga shitja e energjise	42,894	79,890	-36,996	-46%
Te arketueshmet nga shitja e qymyrit	498	1,589	-1,091	-69%
Te arketueshmet nga sherbimet	3,719	4,799	-1,080	-23%
Interesi akrual nga te arketueshmet	9,011	7,150	1,861	26%
	<u>56,122</u>	<u>93,429</u>	<u>-37,307</u>	<u>-40%</u>
Minus Lejimet (shih Shënimin 28.B)	<u>-18,554</u>	<u>-22,617</u>	<u>4,063</u>	<u>-18%</u>
	37,568	70,812	-33,244	-47%
Të arkëtueshmet tjera dhe avanset:				
Avanset ndaj furnitorëve	19,043	1,000	18,043	1804%
TVSH e arketueshme	867	0	867	
Garancioni bankar	10	10	0	0%
Të arkëtueshmet tjera	170	5,588	-5,418	-97%
	<u>20,090</u>	<u>6,598</u>	<u>13,492</u>	<u>204%</u>
Minus Lejimet për të arkëtueshmet tjera dhe avanset (Shënimi 28.B)	<u>0</u>	<u>-45</u>	<u>45</u>	<u>-100%</u>
Gjithsej të arkëtueshmet tjera	<u>20,090</u>	<u>6,553</u>	<u>13,537</u>	<u>207%</u>
Gjithsej	<u>57,658</u>	<u>77,365</u>	<u>-19,707</u>	<u>-25%</u>

Rezervat - të cilat më 31 dhjetor 2023 kapin shumën €207.4milion (2022: €198.5 milion) fillimisht janë llogaritur në librat e Kompanisë, si diferencë midis kapitalit të regjistruar të aksioneve dhe vlerës së pasurive neto të Kompanisë, siç përcaktohet nga vlerësimi i pavarur në data e përfshirjes së saj si SHA (1 janar 2005). Këto rezerva hiqen nga shitja e pasurive të lidhura. Më tej, këto rezerva nuk janë të disponueshme për shpërndarje tek aksionari. Rezervat përfshijnë gjithashtu efektin e tatimit të shtyrë (lëshimin e detyrimit tatimor të shtyrë) të krijuar fillimisht në bazë të rivlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve pas kalimit në SNRF (shkëputur nga Draft Pasqyrat Financiare 2023), po ashtu efektet e rivlerësimeve të periudhës. poashtu KEK ka rritur rezervën nga rivlerësimi i aseteve me €44.7 milion.

Humbjet/Fitimi i akumuluar – KEK ka vendosur të rishkruaj pasqyrat për ndryshimin në trajtimin e humbjeve të bartura ndër vite dhe trajtimin e disa gabimeve të bartura nga periudha të më hershme. Shih tabelën Korrigjimi i gabimit të periudhës paraprake shih për më tepër në PF 2022. Në këtë zë të bilancit përfshihen edhe efektet e performancës financiare neto të periudhës raportuese. Prandaj, meqenëse fitimi i periudhës ishte €12.9 milion, kjo përbën edhe ndryshimin në rritjen prej 11% në këtë zë të bilancit për 2023 krahasuar me vitin paraprak.

Ekuiteti i aksionarëve është rritur për vlerën e fitimit neto të periudhës me 12.9 milion ose me 11%, si dhe për vlerën e rritur të rezervave nga efekti i rivlerësimit të pronave me €44,7 milion krahasuar me vitin 2022 (viti 2023 € 378.1 milion; 2022: € 312.4 milion).

Detyrimet afatgjata kanë vazhduar me trendin e zvogëlimit, kryesisht duke pasqyruar shlyerjen e detyrimeve me pagesat e kësteve të kredisë ndaj Ministrisë së Financave, duke zvogëluar vlerën e stokut të borxhit dhe kjo ka pas një efekt në zvogëlimin e këtij zëri me 10%. Po ashtu, edhe grantet të shtyra janë zvogëluar me 26%. Gjatë vitit 2023, në total detyrimet afatgjata të KEK janë në vlerë €176.3 milion, duke paraqitur një rënie prej 7% krahasuar me vitin 2022 ku vlera e detyrimeve afatgjata ishte €189.4milion.

Detyrimet Afatshkurtra janë në vlerë €49.9 milion ose për €24.9milion ose për 33% më të ulëta se në vitin paraprak (2022: € 74.8 milion). Detyrimet afatshkurtra janë zvogëluar pothuajse në të gjithë zërat ,përfshirë të pagueshmet tregtare me €7.5 milion dhe në grantet e shtyra për import të energjisë të cilat janë po ashtu zvogëluar në vlerë prej €10.8 milion..

Të pagueshmet tregtare në vitin 2023 janë € 13.8 milion, që janë më të vogla për 35% krahasuar me vitin paraprak (2022: €21.5 milion). Ndikim në këtë vlerë, mes tjerash kishte shlyerja e detyrimeve për furnitorët e huaj si dhe zvogëlimi me 2% ose në vlerë €0.24 milion të detyrimeve ndaj furnitorëve vendor. Zë tjetër që ka ndikuar në uljen e detyrimeve afatshkurtër ishte zvogëlimi me € 3.6 milion ose 64% i të pagueshmeve të tjera në këtë kategori. Të dhënat për ndryshimet krahasuese mes viteve raportuese janë paraqitur në tabelën në vijim:

Në EUR '000	2023	2022	≠ ne vlere	≠ ne %
Kreditorët tregtar				
Furnitorët vendor	10,901	11,145	-244	-2%
Furnitorët e huaj	-	2,729	-2,729	-100%
	10,901	13,874	-2,973	-21%
Të pagueshmet tjera rrjedhëse			0	
Pagat për punëtorët	2	-	-	-
Paradhëniet nga klientët	466	541	466	-
Kontribute të pagueshme	119	123	-4	-3%
TVSH-ja e pagueshme	367	885	-885	-100%
Tatime te pagueshme	-	435		
Tjera	2,015	5598	-3,583	-64%
	2,969	7,582	-4,613	-61%
Gjithsej	13,870	21,456	-7,586	-35%

Progresi i Projekteve Kapitale

Efektet e krizës së pandemisë Covid-19 si dhe krizës energjetike kanë dhënë efekte edhe në vitin 2023, në realizimin e projekteve kapitale të KEK ShA. Megjithëse një numër i madh i projekteve vazhdojnë të jenë të kontraktuara kohë më parë, me qëllim të minimizimit të kostove oportune, dinamikat e realizimit të tyre janë të kushtëzuara nga periudhat e planifikuara të realizimit të projekteve të TCB për shkak të periudhës së gjatë të ndalesave. Megjithatë, buxheti vjetor synon të marr parasysh proceset dhe dinamikat ekzistuese, duke synuar që realizimi i buxhetit të synoj stabilizimin e prodhimit të energjisë elektrike, prapëseprapë disa projekte pritet të përfundojnë gjatë vitit 2024 dhe 2025 si projekte afat-mesme të kontraktuara nga ana e KEK-ut me operatorët ekonomik.

Shpenzimet kapitale dhe projektet

Krahasuar me planifikimin buxhetor dhe me nevojat e KEK për investime, kishte një ngecje. Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak kishte një rritje të ndjeshme në vlerën e investimeve të realizuara. Vlera e investimeve të realizuara për vitin sipas Departamentit të buxhetit ishte € 47.5 milion gjatë vitit 2023, ose 50.3% e buxhetit të rishikuar në Korrik 2023. Mosrealizimi i investimeve kapitale sipas planifikimeve gjatë vitit 2023, është i ndërlidhur me një sërë faktorësh i cili përfshin zhvendosjen e projektit të elektrofiltrave për vitet 2025/2026, si dhe ndryshimet në menaxhmentin e KEK. Të gjitha investimet janë financime të brendshme të KEK, dhe nuk ka pasur financim nga burime të jashtme. Shpenzimet për investime kapitale të financuara nga KEK-u sipas divizioneve për periudhën raportuese janë realizuar në shumë prej € 47.5 milionë, paraqiten në tabelën në vijim.

Investimet kapitale në '000€	2023	2022	≠ në vlerë 2023 vs 2022	≠ në % 2023 vs 2022
Mihje	7,010	3,758	3,252	87%
Gjenerimi TCA dhe TCB	39,662	6,996	32,666	467%
Te tjera	834	72	762	1058%
Totali	47,507	10,827	36,680	339%

Divizioni i Mihjeve

Shuma e shpenzimeve kapitale për divizionin e mihjeve për vitin 2023 arrin në €7.1 milion. Lista e shpenzimeve kryesore për këtë divizion duke përfshirë pagesat e faturave me shuma me të larta se 100,000€, është si vijon:

- Përvetësimi i tokave, € 2,2 milion
- Riparim kapital elektromekanik i Ekskavatorit SRs 1300 E-9B, € 0.38 milion
- Kamion trans-Damper 4 copë (2+2), € 0.74 milion
- Elektro motor me rezistues, € 0.13milion
- Elektromotor të kontrolluar me shndërrues të frekuencave, € 0.19 milion
- Furnizim me nyje për SRs 1300, € 0.12 milion
- Furnizim me nyje për SRs 650 (KRUPP), € 0.26 milion
- Furnizim me reduktor te transportit SRs 1300, € 0.19 milion
- Ndërpresë, € 0.17 milion
- Furnizim me xhunta hidrodinamike për sist.S7 dhe TML-AB, € 0.11 milion
- Pjesë ndërrimi për mekanizmin Liebherr, € 0.18 milion
- Pjesë ndërrimi për mekanizmin komatsu, € 0.16 milion
- Pjesë ndërrimi të konstruksionit për mekanizmin e rëndë, € 0.14 milion
- Shirit gome, € 1.1 milion

Dinamika e punës rreth përfundimit të disa projekteve mund të mos përfundojë brenda vitit dhe të vazhdojë në vitin vijues.

Divizionet e prodhimit të energjisë elektrike TCA dhe TCB

Shuma e shpenzimeve kapitale për divizionin e gjenerimit (TC Kosova dhe TC Kosova B) për vitin 2023 arrin në €39.6 milionëve e cila është dukshëm më e lartë se viti paraparak. Lista e shpenzimeve kryesore për këtë divizion është si vijon:

- Remonti kapital i BLL.A5, € 5.1 milion
- Projekti për rregullimin komplet të automatikës për servo mekanizmat e ventilatorëve shtytës dhe flegrat shpejt mbyllëse në bllokun A5, € 0.1 milion
- Furnizim me pjese rezerve për mullinj - Xhunto, Pompa, Ftohëse, € 0.3 milion
- Mirëmbajtje investive ne – MRRK, € 0.15 milion
- Ndërtimi i deponisë së re te hirit ne fushën e Sitnicës, € 0.27 milion

- Furnizimi dhe demontimi-montimi I dy seteve te zbarrave te reja për statorin e gjeneratorëve elektrik për B1 dhe B2, € 0.10 milion
- Ndërrimi i gypave te kondensatorit B1 dhe B2, € 0.45 milion
- Riparimi i ndërprerësve te gjeneratorëve elektrik B1 dhe B2, € 0.14 milion
- Kaldaja - Di latimet dhe kanalet FGR, € 12.89 milion
- Punët ne riparime dhe pjese te nevojshme për LP turbine te B2, € 0.33 milion
- Pllakat rrëshqitëse në PF- kanalet e mullinjëve të thëngjillit, € 0.99 milion
- Modernizimi dhe riparimi I turbinave ne B1 dhe B2, € 16,96 milion
- Mbikëqyrja e projektit te di latimeve te kaldajës B1&B2, € 0.57 milion
- Salla e makinave dhe PKU (pjesë rezervë), € 0.15 milion
- Sistemi i kazantorës - Kaldaja (pjesë rezervë), € 0.20 milion
- Matje, Rregullim, Komandim dhe Hidraulika-MRRK-H (pjesë rezervë dhe kalibrimi PKU), € 0.29 milion.
- Sistemi i Objekteve te jashtme (pjesë rezervë), € 0.24 milion.

Një pjesë e projekteve kapitale për Divizionet TCA dhe TCB do të vazhdojnë edhe në vitin tjetër, sidomos ato në mbrojtjen e mjedisit dhe në kapacitetet gjeneruese.

Drejtoria Qendrore

Tek drejtoria qendrore përfshirë Divizionin e Shërbimeve të Korporatës (që përfshin sektorin e IT-së dhe Ri kultivimit), gjatë vitit 2023 vlera e investimeve kapitale kap shumën e €834 mijë, që përfshinë furnizime me pajisje për data qendër € 58.9 mijë, parku solar me € 686,1mijë, upgrade i ASA Firewall-it me € 54.93 mijë

Plani i biznesit dhe perspektiva për vitin e ardhshëm

Plani i Biznesit 2024 identifikon aktivitetet kryesore të korporatës të cilat janë të orientuara drejt arritjes së objektivave strategjike si në prodhimin e thëngjillit dhe energjisë elektrike, gjithashtu edhe në rritjen e arkëtimit dhe përmasimin e performancës financiare të kompanisë.

Me qëllim të arritjes së aktiviteteve kryesore të korporatës janë vendosur një numër objektivash dhe caqesh të cilat duhet t'i arrijë KEK-u dhe divizionet e saj. Plani i Biznesit do të mundësoj monitorimin e performancës në nivelin qendror dhe në divizione, si dhe përgatitjen e planeve për zbatimin e suksesshëm të strategjisë zhvillimore të KEK-ut për vitet 2024-2028 në të cilën janë përfshirë projektet kryesore

kapitale.

1. Plani Zhvillimor dhe Investiv në Minierat Sipërfaqësore

Bazuar në rezervat e qymyrit miniera ekzistuese do të furnizoj me qymyr kapacitetet ekzistuese gjeneruese deri në vitin 2027.

Plani zhvillimor dhe investiv i minierës është përgatit duke shfrytëzuar dokumentin nga plani i detajuar i prodhimit dhe investimeve për Minierën e Re

Bazuar në Strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031 do të realizohet rehabilitimi i TC Kosova B, si dhe i 1 njësi e TC Kosova A, ndërsa për njësinë e dytë do të vendoset pas periudhës dyvjeçare. Zhvillimi i minierës së re dhe kapaciteti vjetor i saj është i lidhur me TC Kosova B i cili është në proces të rehabilitimit dhe rehabilitimin e njësive të TC Kosova A.

Realizimi i projekteve kapitale do të ndihmoj në rritjen e kapaciteteve për nxjerrjen e qymyrit dhe në sigurinë e operimit në divizionin e qymyrit. Projektet kryesore kapitale të planifikuara të iniciohen gjatë vitit 2024 janë Furnizim me Ekskavatorët rotorik te Qymyrit, dy shiritave vete-lëvizës dhe dy hinkave fushore, Riparim kapital i SHVL (BRs1600.60), Riparim kapital i Palosit A2Rs B 44000 P-1B, Riparimi kapital i Ekskavatorit E-10 M, furnizim me Kamion transportues -Damper 10 (dhjetë 2+8) copë. Në vitin 2024 planifikohen te shpronsohen 72 Ha, si dhe te shiten rreth 300,000 tone Qymyr.

2. Plani Zhvillimor dhe Investiv i TC Kosova A

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031 parasheh realizimin e rehabilitimit të një njësie të TC Kosova A (njësia A3), ndërsa në periudhën dy vjeçare do të vendoset për rehabilitimin e njësisë së dytë të TC Kosova A.

Investimet kapitale të planifikuara të realizohen do të ndikojnë në stabilizimin e gjendjes së operimit të njësive gjeneruese në periudhën e ardhshme. Projektet kryesore të planifikuara të realizohen gjatë vitit 2024 janë: Rehabilitimi i njësisë A3, Furnizimi me transformator energjetik 220/6.3kV 40MVA, Furnizim me pjesë rezervë për mullinjtë, stabilimentet elektrike gjenerator – zgjuese, furnizimi me Buldozer me vemëza, riparimi dhe furnizimi me dërrasa të integrueme për kullën ftohëse, sigurimi i kompresorit, mirëmbajtte investive për matje rregullim dhe komandim në njësitë A3, A4 dhe A5, dhe furnizimi me pajisjet elektrike. De-Komisionimi i pjesëve jothelbësore të TC Kosova A:

Njësi të këtij termocentrali e kanë kaluar jetëgjatësinë e tyre, gjithashtu është në proces e sipër de-Komisionimi dhe çmontimi i objekteve të gazifikimit, azotikut, ngrohtores dhe objekteve tjera që nuk e pengojnë operimin normal të njësive aktive të TC Kosova A, në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/156 “Shfrytëzimi i linjitet në pajtim me të gjitha kërkesat të mbrojtjes mjedisore (ndërtimi, rehabilitimi dhe rindërtimi i kapaciteteve gjeneruese) duhet të plotësoj kriteret

mjedisore siç është përcaktuar në komunitetet e energjisë e që janë pasqyruar në kriteret e BE-së: 04/156.”

Gjendja aktuale është si më poshtë:

- KEK-u, MMPHI (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe komuna e Obiliqit në qershor 2022 kanë nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi qëllimi i së cilës është përcaktimi i lokacionit për ndërtimin e Magazinës së Mbetjeve të Rrezikshme në hapësirat e ish Azotikut -TC Kosova A në afërsi të hangarit;
- Zyra e BE (Bashkimit Evropian) në Kosovë ka filluar fazën e re të kontratës me konsulentin SWECO, qëllimi kryesor i së cilës është përgatitja e studimit dhe dokumenteve të tenderit për ndërtimin e objektit të magazinimit të përkohshëm të mbetjeve të rrezikshme;
- Ky studim dhe hartimi i dokumenteve të tenderit për Magazinën e Mbetjeve të Rrezikshme duhet të përfundojë deri në fund të këtij viti (15 dhjetor 2023);
- Ende nuk ka një vendim për fillimin e zbatimit të projektit të dekomisionit të objekteve që nuk janë më në përdorim në TC Kosova A;
- Parakushtet për fillimin e këtij projekti është ndërtimi i Magazinës së Mbetjeve të Rrezikshme;
- Ndërtimi i Magazinës së mbetjeve të rrezikshme si dhe dekomisionimi i objekteve që nuk janë më në përdorim në TC Kosova A, gjithashtu do të duhet t'i nënshtrohen procesit të miratimit si dhe vendimit për mënyrën e zbatimit, dhe
- Ka diskutime të vazhdueshme me Qeverinë e Kosovës si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare me qëllim të përcaktimit të modaliteteve të zbatimit dhe përgatitjes së propozimit për financimin e këtyre projekteve.

3. Plani Zhvillimor dhe Investiv i TC Kosova B

Investimet në TC Kosova B kryesisht bazohen në Studimin e Fizibilitetit të financuar nga Komisioni Evropian në qershor të vitit 2017 për rehabilitimin e TCB-së. Projektet kryesore kapitalet të planifikuara të realizohen gjatë vitit 2024 janë:

Rehabilitimi i TC Kosova B do të ndikojë në plotësimin e kërkesave ambientale, respektivisht zvogëlimin e ndotjes së ajrit ashtu që të arrihen standardet e direktivave të Bashkimit Evropian (BE) lidhur me emisionet e pluhurit dhe gazrave, do të rris jetëgjatësinë e TC Kosova B për 20 - 25 vite, si dhe do të rris fuqinë nominale të njësive

të TC Kosova B dhe disponueshmërinë e njësive, që do të ketë ndikim direkt në rritjen e

prodhimit të energjisë elektrike. KEK-u gjithashtu në tetor 2021 ka aplikuar në

programin, për grant në vlerë 95 milion Euro për realizimin e projektit për ndërtimin e impiantit për

zvogëlimin e SO₂. Investimet në elektrofiltra dhe pajisjet për zvogëlimin e oksideve të azotit (NO_x-it) fillimisht janë planifikuar të realizohen në vitin 2020 në njësinë B1, ndërsa në vitin 2021 në njësinë B2 të TC Kosova B, mirëpo për shkak të gjendjes së krijuar me COVID 19 realizimi i projektit është zhvendosur në vitet 2025 dhe 2026. Investimi në projektin e dilatimeve të kaldajës është realizuar në njësinë B2 dhe B1 në vitin 2023 dhe investimi është kryer nga ana e KEK-u ku (vlera e projektit rreth 20 mil. euro). Projektet kryesore kapitale të planifikuara për tu realizuar në vitin 2024 janë:

Ndërrimi i gypave të kondensatorit të njësisë, riparimi i ndërprerësve të gjeneratorëve elektrik të njësisë, rehabilitimi i kanalit kryesor të gazrave, rehabilitimi i dhënësve të thëngjillit në njësitë.

Projektet Kryesore:

- Kanali kryesor i gazrave në B1 dhe B2
- Rehabilitimi i dhënësve të thëngjillit në B1 dhe B2
- Riparimi i ndërprerësve të gjeneratorëve elektrik B1 dhe B2

4. Burimet e Ripërtrishme

KEK-u ka realizuar studimin e fizibilitetit për ndërtimin e parkut solar. *Dokumenti* final është dorëzuar në maj të vitit 2020. Bazuar në studimin e fizibilitetit në *hapësirën* e planifikuar prej 150 hektarëve do të ndërtohet parku solar me kapacitet prej 100 MW. KEK-u ka aplikuar për grant në WBIF (Western Balkan Investment Framework) dhe në kuadër të kësaj është finalizuar dokumenti minutat e takimit i cili është nënshkruar në mes të Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe KEK-u. Në muajin tetor 2023 është nënshkruar marrëveshja për grant dhe kredi nga KfW, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe KEK-ut.

Marrëveshja për kredi me Bankën Evropiane për Investime (BEI) do të nënshkruhet në fillim të vitit. Vlera e planifikuar e projektit të parkut solar është 103.33 Milion Euro, ku 30 % e vlerës së projektit është grant, ndërsa pjesa tjetër është kredi e ndarë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe Bankën Evropiane për Investime (BEI). KEK-u merr pjesë me vlerë shtesë në projekt prej 10 milion Euro.

Elementet kryesore të Projektit:

- Programi WBIF (Western Balkan Investment Framework)
- Kapaciteti 100 MW;
- Prodhimi vjetor 162 GWh;
- Kostoja e projektit 103.33 milion Euro;
- Grant 30% e vlerës së projektit pjesa tjetër kredi e butë;
- KEK-u 10 milion Euro kontribut vetanak, dhe
- Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe Evropan Investment Bank (EIB)

kreditorët e projektit.

- Kredi prej 29milion EUR nga KfW
- Grant prej 31.679milion EUR nga WBIF
- Pjesa prej 33milion EUR kredi nga EIB
- Kostot shtesë që mund të dalin në projekt, rreth 10milion EUR mbulohet nga KEK

Fazat e zhvillimit të projektit:

Aktivitetet	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Përgatitja e projektit						
Nënshkrimi i kontratave (KfW, EIB, WBIF granti)		X	X			
Nënshkrimi me Tender Agjentin	X					
Tenderimi i Konsulentit Solar IC		X				
Kontrata me Konsulentin Solar IC			X			
Implementimi i projektit						
Përgatitja doc. tenderuese për implementim			X			
Tenderi për kompaninë implementuese			X			
Nënshkrimi i kontratës				X		
Implementimi i projektit				X	X	
Shërbimet e konsulentit (teknike dhe institucionale)			X	X	X	X
Mbyllja e projektit						
Periudha e mbulimit te defekteve						X
Mbyllja e projektit						X

5. Raporti i vlerësimit të tokave LURA nga Banka Botërore

Në vitin 2023 KEK bashkë me Bankën Botërore ka kryer analizën e mbi 2600 hektar të tokave të pashfrytëzuara të KEK-ut. Raporti përfshin ish deponitë e hirit, deponitë e djerrinave, gasifikimin, minierat etj. Si rezultat nga raporti, opsionet e përgjithshme kryesore të ripërdorimit të tokës për zonën e përfshirë të KEK-ut janë:

- prodhimi i energjisë dhe industria e lehtë (60.51%),
- pyll, habitate natyrore (0%)
- bujqësi (34.92%)
- zhvillim biznesi/banimi (0%)

- zona e mbetur aktualisht mbulohet nga trupi i mundshëm ujqor (3.65%).

Kjo analizë parasheh mbi 735 hektar të tokave të analizuara që janë zona të gatshme për zhvillim (“areas ready for development”) me intervenime minimale të terrenit. Këto zona janë të përshtatshme për prodhim dhe ruajtje të energjisë nga burime të ripërtrishme.

Raporti i vlerësimit të ripërdorimit të tokave nga Banka Botërore shfaq hapësira të mëdha zhvillimore të projekteve të energjisë së ripërtrishme në tokat e KEK-ut. Nga rezultatet e raportit tregohet që zona e Deponisë së Jugut ka potencial të lartë zhvillimor të projekteve solare. Përveç intervenimeve minimale në teren, deponia ka afër edhe nënstationet e rrjetit energjik çka e bënë zonë shumë të favorshme për energji të ripërtrishme.

KEK planifikon të zhvilloj fillimisht një studim fizibiliteti për një projekt solar me kapacitet 200MW në këtë zonë. Studimi i fizibilitetit do të hap rrugë tutje për zhvillimin e projektit në formën më të favorshme për KEK-un. KEK veçse ka dorëzuar draft aplikimin në Ministrinë e Ekonomisë për grant të asistencës teknike nga WBIF për këtë studim. Pavarësisht kësaj, Banka Botërore ka shprehur gatishmëri që mund të ndaj fonde/grant për një studim të tillë fizibiliteti për projekt solar 200MW në Deponinë e Jugut. KEK parasheh që ky studim i fizibilitetit të jetë shumë i detajuar i cili do të i mjaftueshëm për të vazhduar me fazat e tjera përgatitore për projekt. Ky aktivitet parashihet të përmbaj:

- Studimin e fizibilitetit për deponinë e djerrinës Jugu për projekt solar 200MW
- Analizat gjeoteknike, sizmike dhe hidrologjike të asaj zone
- Vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) për këtë projekt duke përfshirë edhe Pëlqimin Mjedisor
- Analizën e lidhjes në rrjetin energjetik të projektit solar 200MW, duke përfshirë Informatën teknike nga KOSTT

Ambienti

KEK është e vetmja Korporatë në Kosovë që prodhon energjinë elektrike, bazuar në lëndë fosile-qymyryn linjit si lëndë djegëse.

Përdorimi i lëndëve me bazë fosile, pashmangshëm rezulton me ndikim primarë në mjedis respektivisht në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit.

Në pajtim me politikat mjedisore, KEK-u të gjitha aktivitetet afariste synon ti bazoj në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm që nënkupton menaxhim të përgjegjshëm, afarizëm pozitiv, në pajtueshmëri dhe mirëbesim me të gjitha palët e interesuara si dhe zhvillim dinamik ,miqësor ndaj mjedisit dhe që nuk e cenon atë.

Përkundrazi KEK-u synon të ruaj, mbroj dhe avancoj gjendjen e mjedisit përmes zbatimit të kërkesave ligjore dhe standardeve vendore dhe ndërkombëtar, përpjekjeve për monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve mjedisore, të veprojnë në mënyrë preventive dhe mbikëqyrë vazhdimisht emisionet në ajër, ujë dhe tokë, të ruan biodiversitetin si dhe të zvogëlojnë nivelin e zhurmës.

Bazuar në politikat mjedisore, KEK-u angazhohet në krijimin hap pas hapi të strukturave të nevojshme për themelimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen të Sistemit për Menaxhim të Mjedisit (SMM) sipas ISO 14001-2004 si dhe integrimin e problematikave mjedisore në planet zhvillimore dhe strategjinë e KEK-ut.

Në funksion të kësaj, KEK-u do të përkushtohet për shfrytëzimin optimal, racional dhe përgjegjës të resurseve natyrore si dhe të lëndëve të para shtesë, rritjen e efikasitetit të pajisjeve, avancimin e vazhdueshëm të procesit të prodhimit, modernizimin e minierave dhe eksploatimin e kontrolluar të linjitetit kualitativ, rritjen e shkallës së koogjenerimit, do të angazhohet për minimizimin e gjenerimit të mbeturinave, trajtimin e mbeturinave të rrezikshme dhe menaxhimin sa më të mirë të tyre.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar disa aktivitete që kanë për qëllim realizimin e politikave mjedisore të KEK sh.a. ndërsa aktivitete të tjera janë në proces të planifikimit dhe zhvillimit.

Ka vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikimit dhe përgatitjes së hapësirave në Parkun KEK II në një sipërfaqe rreth 20 ha, rregullimi i rrjedhave dhe pellgjeve ujore, është shtuar fondi i drunjëve në këto hapësira,

Janë mirëmbajtur hapësirat e TC Kosova A dhe Zonës së Seperimeve Kimike, janë ruajtur si dhe mirëmbajtur plantacionet në Lismir .

Gjatë vitit 2023 është vazhduar me shumë sukses bashkëpunimi me Zyrën e BE në Kosovë, MMPHI dhe komunën e Obiliqit lidhur me realizimin e procesit të dekomisionimit në Zonën e Seperimeve Kimike dhe ndërtimit të Magazinës për Ruajtjen e Përkohshme të Mbetjeve të Rrezikshme si dhe bashkëpunimi me Bankën Botërore, MMPHI, Komunën e Obiliqit dhe komunën e Fushë Kosovës, lidhur me realizimin e projektit Parku KEK I.

Janë iniciuar aktivitetet e prokurimit për grumbullimi, ambalazhimi dhe magazinimi i mbetjeve dhe materialeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral në hapësirat e TCB,TCA dhe DPQ, projekt ky që do të ndikojë në zvogëlimin e ndjeshëm të rrezikut për punëtorët e KEK dhe banorët e zonës

Është iniciuar aktiviteti i prokurimit për projektin “ Trajtimi i vajrave me përmbajtje të bifenoleve të polikloruara BPK/ PCB, që ndjeshëm do të ndikojë në zvogëlimin e rrezikut për punëtorët e KEK-ut dhe banorët e zonës

Është duke u punuar në Hartimin e Planit për Menaxhimin e Integruar të Materialeve dhe Mbetjeve të Ngurta dhe të Lëngëta në të gjitha divizionet e KEK-ut, realizimi i të cilit do të ndikojë drejtpërdrejt në

zvogëlimin deri në eliminimin e plotë të mbetjeve nga hapësirat punuese, menaxhimin e mirëfilltë të tyre, përmes zvogëlimit të rrjedhës së mbetjeve në burim, grumbullimit, selektimit, riciklimit, magazinimit të rregullt dhe valorizimit të tyre.

KEK-u bazuar në Rregulloren për Vlerësimin e Provizioneve, sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të KEK sh.a. nr.1913 datë 17.03.2021.bën vlerësimet e detyrimeve ndaj ambientit dhe i njeh si provizione në Pasqyra Financiare.

Nga viti 2022 shuma e projekteve të vlerësuar në total ishte 43,103,013.00 dhe kishte shuma që janë shpenzuar në vlerë 257,738.03 Euro, ndërsa në vitin 2023, kemi një vlerë të bartur në shumën 42,845,274.97, nuk kishte shtesë dhe as rritje në provizionet aktuale,

Është shpenzuar shuma në vlerë 25,848.39 dhe nuk kishte shuma të kthyera të pa shpenzuara, apo heqje dorë nga ndonjë prej projekteve të parashikuara.

Plani i Divizionit të Mihjeve

Gjatë vitit 2024, Divizioni i Prodhimit të Qymyrit (DPQ) ka një rritje në planifikimin e prodhimit: 9 milionë ton prodhim të qymyrit dhe 15.4 milionë m³ të djerrinës, duke furnizuar termocentralet me qymyr në sasi të duhur dhe në kohë, si dhe mbajtjen e rezervave të qymyrit në sasinë e planifikuar. Tabela e planit të biznesit 2024 për këtë divizion, është si vijon:

Nr.	TREGUESIT KRYESORË TË PËRFORMANCËS	Njësia	Plani për vitin 2024
1	Sibovci Jug-perëndimor		
	Prodhimi i qymyrit	ton	9.000.000
	Zhvendosja e djerrinës	m ³	15.400.000

Tabela: Plani i Biznesit 2024 Divizioni i Mihjeve

Sasia dhe cilësia e thëngjillit planifikohet duke u bazuar në bilancin energjetik, dhe sasia e djerrinës përcaktohet bazuar në konfigurimin e terrenit. Po ashtu një sasi prej mbi 500 mijë ton, është e planifikuar në të hyrat e KEK nga shitja në treg të jashtëm. Realizimi i këtij plani është i kushtëzuar edhe nga kushtet teknike të pajisjeve dhe realizimi i investimeve kapitale të cilat pritet të përmbillen gjatë vitit 2024.

Plani i Divizioneve TCA dhe TCB për gjenerimin e energjisë

Plani për prodhimin e energjisë elektrike është zhvilluar në bazë të Bilancit Vjetor Energjetik të KEK-ut Rishikuar në Janar 2024 dhe aprovuar nga ZRRE në 06.02.2024. Për realizimin e planit, kusht kryesor është furnizimi i vazhdueshëm i thëngjillit në sasi të duhur, në përputhshmëri me planin e pajtuar edhe me Divizionin e Mihjeve. Po ashtu për shkak të vjetërsisë së pajisjeve kryesore të prodhimit

KEK në aktivitetin e vet shoqërohet me në rrezik të lartë të ndërprerjeve të paplanifikuara të prodhimit si rrjedhojë e defekteve të ndryshme. Realizimi i investimeve të planifikuara me kohë dhe me cilësi është vetëm një masë në zvogëlimin e këtyre rreziqeve nga ndërprerjet dhe ndikon në realizimin e planit të prodhimit. Tabela e planit të biznesit 2024 për Divizionet e Gjenerimit është si vijon:

Nr.	TREGUESIT KRYESORË TË PËRFORMANCËS	Njësia	Plani për vitin 2024 (MESATARJA/TOTALI)
1	GJENERIMI BRUTO	MWh	
	Kosova A	MWh	2,419,756
	Kosova B	MWh	4,075,241
2	GJENERIMI NETO	MWh	
	Kosova A	MWh	2,129,280
	Kosova B	MWh	3,684,000

Tabela: Plani i Biznesit 2024 Divizioni i Gjenerimit

Sipas planit vjetor, njësia B1 pritet të ketë gjithsej 47 ditë ndalesa të planifikuara me 12 ditë për revizione (6 ditë në muajin Prill dhe 6 ditë në muajin Tetor 2024) si dhe 35 ditë ndalesa për riparime gjatë muajit Qershor dhe Korrik. Po ashtu, njësia B2 është planifikuar të ketë ndalesa prej 47 ditësh, me 12 ditë për revizione (6 ditë në muajin Prill dhe 6 ditë në muajin tetor) si dhe 35 ditë për riparime në muajt Korrik dhe Gusht 2024.

Në TCA plani ndalesave është më i madh për shkak të vjetërisë së pajisjeve dhe nevojave teknike për monitorim dhe intervenime më të shtuara. Për Revizion janë planifikuar nga 16 ditë ndalesë në A3 dhe A5, ndërsa 24 në njësinë A4. Po ashtu ndalesa për Rezerva janë të planifikuara 67 ditë për njësinë A3, 47 ditë për njësinë A4 dhe 49 ditë për njësinë A5. Plani i riparimeve po ashtu është planifikuar ndalesë me nga 25 ditë për A3 dhe A4 ndërsa 60 ditë për A5. E gjithë kjo ndikon në projeksionet për disponueshmerinë e njësive operuese, megjithatë kjo është në funksion të uljes së rreziqeve dhe realizimin e planit të prodhimit.

Menaxhimi i rreziqeve të Korporatës

Korporata ballafaqohet me pasiguri të ndryshme në aktivitetet e veta për të siguruar realizimin e objektivave. Për këtë qëllim, sipas kërkesave të ligjit 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të Financave Publike,¹ rregulloren e MF Nr. 01/2019² për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e rreziqeve, ndër përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve, respektivisht Kryesuesit të tij është përgjegjës, i njohur në këto ligje si udhëheqësi i SSP³ të përshkruara në nenin 4, paragrafi 1.7, si dhe në nenin 12 Menaxhimi i rrezikut që thotë se është përgjegjës për *vendosjen e sistemit të menaxhimit*

¹ [LIGJI NR. 06/L-021 KONTROLLIN E BRENDSHËM TË FINANCIVE PUBLIKE \(rks-gov.net\)](#)

² [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\) RREGULLORE MF- NR. 01/2019 PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN](#)

³ [Udhëheqësi i SSP \(Subjekt i Sektorit Publik\) sipas ligjit në rastin e KEK Kryetarit i BtD.](#)

të rrezikut të dokumentuar dhe përfshin identifikimin, vlerësimin dhe veprimet për zvogëlimin e rrezikut në mënyrë që të arrihen objektivat e organizatës (f.10 dhe 13).


Menaxhimi i rreziqeve sipas kërkesave ligjore, kërkohet të bëhet të paktën një herë në vit. Megjithatë KEK e rishikon rreziqet e veta në baza tremujore. Gjatë vitit 2023, fokus të veçantë në proces të rishikimit të rreziqeve të veta kishin kuartalet që lidhen me planifikimet buxhetore si masë për menaxhimin e rreziqeve të cilat kërkojnë mjete buxhetore. I tillë ishte TM3 2023, që kishte synim edhe të jetë në të njëjtën kohë me procesin e buxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026. Ku gjatë procesit të buxhetimit është mbajtur fokusi në përfshirjen e aktiviteteve për minimizimin e rreziqeve dhe që të ruaj kursin drejt realizimit të objektivave pa kosto të paparashikuara ose me kosto sa më vogla. Ndërsa procesi menaxhimit të rreziqeve për vitin 2024 ka filluar me 22.12.2023 dhe finalizohet me aprovimin e raportit në BtD.

Palët e interesuara duhet ti kushtojnë vëmendje këtyre treguesve të rrezikut të identifikuar nga burime të brendshme të vlerësimit dhe mbi këto informata dhe të dhënat historike mund të ndikojnë në opinionin e tyre lidhur me ecurinë e KEK-ut në të ardhmen, dhe përpjekjeve që KEK është duke bërë për ruajtjen e vazhdimësisë në rritjen e vlerës për aksionarin, nën vëmendjen e ekzistimit të rreziqeve të cilat bartin pasiguri dhe rreziqe që mund të afektojnë arritjen e synimeve.

Identifikimi i rreziqeve

Hapi i parë në procesin e menaxhimit të rreziqeve është identifikimi i tyre. Sipas ligjit 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në nenin 8 identifikimi i rreziqeve bie mbi bartësit e tyre pra menaxherët/udhëheqësit e njësisive. KEK e realizon këtë përmes procesit të pyetësorëve/ formularëve të adaptuara sipas kërkesave të rregullores MF 01/2019 (shih aneksin në fund të këtij dokumenti). Përmes këtyre formave, në nivele të ndryshme të vendimmarrjes identifikohen ngjarje të mundshme të cilat mund të rrezikojnë arritjen e objektivave të korporatës sipas strukturës dhe skemës ekzistuese të organizatës. Për të lehtësuar procesin, format e pyetësorëve kanë edhe pyetjet dhe analizës së situatave të mundshme se çfarë mund të ndodh, ku, kur dhe si mund të ndodh?! Si dhe kush është personi përgjegjës bartës i rrezikut. Bartësit e rrezikut janë në nivele të ndryshme personat të cilët e kanë në dorë menaxhimin e aseteve dhe/ose operimin e to, dhe aprovohen nga drejtorët e divizioneve ose departamenteve.

Rreziqet e korporatës janë të grupuara sipas nivelit të vendimmarrjes, në: Strategjike, financiare, Operative dhe të përputhshmërisë. Për nga pjesëmarrja në total regjistrin e rreziqeve paraqiten në grafikun si vijon:



Aplikimi i procedurës për menaxhimin e rrezikut, ka për qëllim jo thjeshtë t’iu përgjigjet kërkesave ligjore, por përmes menaxhimit të rrezikut synohet rritja e efikasitetit dhe cilësisë së menaxhimit si një garancion për të siguruar realizimin e planeve financiare dhe operative. Po ashtu, inkurajon të menduarit kritik dhe qasjen mbrojtëse në realizimin e objektivave afatgjatë dhe strategjike të biznesit.

Rreziqet strategjike

Gjatë dy viteve të fundit, korporata ka pësuar ndryshime të vazhdueshme në strukturat udhëheqëse të saj, përfshirë Bordin Drejtues si dhe shumicën e drejtorëve në strukturën e menaxhmentit ekzekutiv, duke u përballur me një nivel të caktuar rreziku. Po ashtu, gjatë vitit 2023 korporata vazhdoi të operoj me një numër të madh të divizioneve dhe departamenteve të cilat menaxhohen me ushtrues detyre. Këto përbëjnë rreziqe strategjike, që lidhen me proceset e vendimmarrjes të nivelit të lartë dhe përfshijnë aspekte të ndryshme, si kulturën dhe qeverisjen e korporatës, pamjaftueshmëritë e planifikimit buxhetor dhe strategjik, rregullimet e politikave të çmimeve, transparencën ndaj aksionarëve dhe palëve të interesuara detyrimet e përgjegjësisë sociale të korporatës, dhe nxitjen e një komunikimi të brendshëm efektiv, etj.

Një nga ngjarjet kritike strategjike që ndikon në fatin e TC Kosova A, është aprovimi në vitin 2023 i Strategjisë për Energjinë 2022-2031 Qeverisë së Kosovës. Kjo strategji është e gatshme, dhe synon të mbështesë ligjërisht drejtimin strategjik afatgjatë për investimet e KEK-ut në TCA dhe vënien në punë të tij. Realizimi i projektit të rindërtimit të njësisë A3 të TCA është një sfidë strategjike.

KEK-u për vite me radhë ka ndarë mjete për blerjen e pajisjeve të reja për Minierën e Re. Kulmi i këtij procesi prokurimi u arrit në vitin 2020 me hartimin e specifikimeve teknike për dy ekskavatorë, të lehtësuar nga konsulentët e punësuar nëpërmjet USAID-it, pas një marrëveshjeje me MZHE. Sidoqoftë, viti 2023 nuk pa asnjë përparim të mëtejshëm në këtë përpjekje, duke çuar në shtyrje të pacaktuara.

Në përpjekje për të rritur efikasitetin dhe performancën, Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i KEK-ut kanë iniciuar një rishikim funksional të strukturës së tij organizative që nga viti 2020. Ky rishikim ka pësuar vonesa për shkak të ndryshimeve të shpeshta të leadershipit, por është në vazhdim dhe pritet të përfundojë në vitin 2023. KEK-u gjithashtu ka kërkuar të modifikojë Marrëveshjen e Furnizimit me Shumicë që nga viti 2019, duke synuar të fitojë më shumë ndikim në negociatat vjetore të çmimit të energjisë. Përkundër këtyre

përpjekjeve dhe duke qenë një entitet i de-rregulluar që nga viti 2017, KEK-u ka luftuar të pasqyrojë kostot e tij në rritje të prodhimit në marrëveshjet vjetore të çmimeve me partnerët kryesorë KEDS dhe KESCO për shkak të kufizimeve të marrëveshjes.

Për më tepër, zbatimi i projektit të elektrofiltrave, i financuar nga BE-ja, ka ndikuar në afatin kohor dhe profilin e rrezikut të të gjitha projekteve të KEK-ut, duke sjellë sfida shtesë në procesin e re-vitalizimit të TCB si një përpjekje strategjike e korporatës drejt rritjes së stabilitetit të prodhimit dhe sigurisë financiare të saj.

Si përmbledhje, KEK si rrjedhojë e ngjarjeve të mëdha dhe objektive, ka ngecur në avancimin e projekteve të veta madhore duke rritur kompleksitetin e këtyre sfidave, rrjedhimisht ekspozimi ndaj rrezikut strategjik të organizatës. Kjo mund të menaxhohet me aprovimn e detajuar të strategjisë së korporatës për të ardhme më të sigurt të saj dhe për të bërë të parashikueshëm vazhdimësinë e biznesit dhe rritur performancën e saj. Megjithëse gjatë 2023 një draft dokument i këtij orientimi është përpiluar KEK ende nuk ka të aprovuar një strategji të korporatës. Këto përpjekje janë thelbësore për përafrimin e rrugëtimit të korporatës me strategjinë e qeverisë për energjinë dhe optimizimin e efijencës operationale. Ndërsa vitet kalojnë, fokusi i KEK-ut në planifikimin strategjik mbetet thelbësor për tejkalimin e këtyre sfidave dhe arritjen e suksesit afatgjatë.

Rreziqet e tregut dhe nga palët e treta

KEK përcillet nga rreziqe të mundshme nga mos përmbushja e detyrimeve nga palët e treta jo vetëm nga realizimi i obligimeve në shitjet e KEK por edhe në blerje. Ky është një faktor i rrezikut që ka ndikuar në vitin 2023 dhe vazhdon të jetë i mundshëm përgjatë periudhës së ardhshme .

- Periudha post krizave të pandemisë dhe asaj të energjisë ka rritur mundësitë e vonesave në realizim dhe dështimeve në realizim të kontratave, si rrjedhojë e problemeve të shkaktuara nga mbyllja e fabrikave, raste të zjarreve, reduktimet në prodhim si rrjedhojë e reduktimeve të stafit, mbyllja pamundësia e lëvizjes etj. Kjo formë e rreziqeve nga kontratat ishte e mbuluar me transferim të rreziqeve dhe rishikimet ishin te mundshme.
- Problemet me palët e treta lidhen edhe me problemet globale dhe vatrave të luftërave në rritje të cilat rrisin rreziqet e parashikueshmërisë së çmimeve. Kjo ka shkakton në zingjirin furnizues dhe në rritjen e çmimeve për furnizimet e KEK.
- Edhe gjatë vitit 2023, ka ndodhur probleme dhe vonesa në realizimin e disa kontratave për shkak të faktorëve të ndryshëm. KEK këtë lloj të rrezikut pavarësisht nga nevoja e kontratës nuk mund ta menaxhojë përveç me shkëputje si rrjedhojë e kërkesave të LPP. Një zgjidhje e aplikuar në KEK është edhe lidhja e kontratave kornizë, dhe me afat më të gjatë kohor.

- Mungesa e analizës së rreziqeve të palëve të treta. Psh KEK nuk ka informata dhe nuk kërkon informata të tilla për rastet kur OE mund të kenë dështuar në realizimin e detyrimeve ndaj të tjerëve. Mirëmbajtja e një regjistri në nivel kombëtar do të ndikonte në të gjithë autoritetet kontraktuese, ku edhe KEK do të zvogëlonte rrezikun e operimit me operator ekonomik të papërgjegjshëm.
- KEK vazhdon të ballafaqohet me konteste të shumta gjyqësorë të cilat bazohen kryesisht në interpretime të kaluara ligjore dhe zbatimin praktik të ligjit të punës ose me konteste të ndryshme në zbatimin e tij. Rastet përfshijnë edhe ish/punëtorët e KEK, kryesisht raste të vjetra të cilat datojnë nga ndarja e distribucionit por edhe konteste të tilla për pagesat e orëve jashtë orarit dhe të vikendeve, cila është humbur nga KEK dhe janë kompensuar palët, por që për raste të njëjta vashdon të ketë padi të reja.
- Ekzistojnë vonesa nga OSHP në trajtimin e lëndëve dhe ankesave të palëve ndaj vendimeve të Zyrës Ekzekutive të Prokurimit, të cilat shkaktojnë vonesa në realizimin e projekteve të KEK. Mungesa e trajnimeve të mjaftueshme dhe adekuate për proceset e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Ekzistojnë edhe probleme të natyrës së hartimit të specifikave teknike dhe probleme të tjera me përcaktimin e prioriteteve në blerjet e iniciuara, të identifikuar nga ana e ZEP.

Rreziqet financiare

Me fillim nga fundi i vitit 2022, dhe përgjatë 2023, KEK ka rritur kompleksitetin në operimet financiare përmes fillimit të investimeve në letra me vlerë dhe në depozita me afat, duke rritur kthimin neto nga investimet financiare. Po ashtu kjo periudhë ishte e shoqëruar me rritje të ndjeshme të transaksioneve financiare me palët e treta si rrjedhojë e rritjes së tregtimit të drejtpërdrejtë të energjisë elektrike, si aktivitete në menaxhimin e krizës energjetike. Pavarësisht këtyre KEK ka arritur të mbaj një nivel optimal të rrezikut financiar përfshirë nivel të lartë të likuiditetit dhe performancës financiare. Rreziqet financiare janë ato që raportohen, monitorohen dhe menaxhohen në nivelin më të lartë hierarkik të korporatës, dhe bien nën përgjegjësinë e Bordin Drejtues dhe zyrtarët e lartë të korporatës. Aktualisht raporti borxh/ekuitet, është ulur nga 0.41 sa ishte në vitin 2022 në 0.31 në vitin 2023. Ky zvogëlim është tregues i aftësisë së korporatës për vet shlyerjen e detyrimeve në periudha afatgjatë. Viti 2023 dhe sigurisht viti 2024 në vazhdim, si periudhë post krizash (e Pandemisë gjatë vitit 2021 dhe kriza globale e energjisë gjatë vitit 2022) ka ndikuar që KEK të përballet me rreziqeve financiare, kryesisht në:

- Realizimin e të hyrave duke vazhduar përbalje me nivele të ndjeshme në zgjatjen e ditëve të vonesës së pagesës së faturave, me një ndikim të pashmangshëm në nivelin e parasë së gatshme.

- EBITDA si tregues i aftësisë së korporatës për të investuar në asete fikse, ka një vlerë më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2023 është kalkuluar në € 64.2 milion, krahasuar me €165 milion në vitin 2022. Rënia e konsiderueshme në vlerën e EBITDA është pasqyrim i efikasitetit operacional dhe përfitueshmërisë së kompanisë. Kjo rënie mund t'i atribuohet në masë të madhe edhe rënies së çmimeve në bursat e energjisë elektrike. Por pashmangshëm edhe rritjes së kostove operacionale si rezultat i çmimeve më të larta gjatë 2023 si dhe uljes së vëllimit të shitjeve, si rrjedhojë e sasisë së energjisë në dispozicion.
- Edhe gjatë vitit 2023 KEK ka vazhduar me investime në instrumente financiare si depozita me afat dhe letra me vlerë. Me rritjen e portofolios së investimeve financiare, KEK ka rritur përfitimet, megjithëse ekziston një nevojë emergjente për realizimin e investimeve kapitale të buxhetuara në periudha afatmesme e cila duhet të prioritetizohet në raport me aktivitetet e tjera financiare të korporatës. Kjo do të rriste nevojën për harmonizimin e kërkesave dhe detyrimeve në rrjedhën e parasë së gatshme.
- Raportimi dhe kontrolli financiar, në këtë aspekt KEK ka një dozë të rrezikut e cila vjen nga mënyrat e raportimit dhe përdorimi i softuerëve të vjetër dhe me probleme të theksuara të sigurisë për sa i përket kontrolleve të brendshme. Megjithatë, me aplikimin e softuerit të ri financiar si dhe me angazhimin e stafit shtesë gjatë vitit 2022, pritet që një pjesë e këtyre rreziqeve do të eliminohen. Gjatë vitit 2023, sfidë ishte dhe mbetet trajnimi i stafit për përdorimin e ERP dhe angazhimin e stafit të ri për pozita të domosdoshme.
- Ndryshimet e shpeshta në çmimet e produkteve dhe sidomos, karburanteve dhe metaleve në tregje globale, kanë shkaktuar probleme financiare për KEK duke bërë të nevojshme edhe rishikimin e kushteve të kontratave apo edhe kërkesa për ndërprerjen e tyre ose mos nënshkrim në disa raste. Ndryshimet e shpeshta në tarifatat e aprovuara nga ZRRE për çasjen në rrjetin e KOSTT, kostot e prodhimit jo-konkurrese/mos pranimi i kostove të prodhimit në çmimet e energjisë, ndryshimi në normat e interesit ka ndikim të drejtpërdrejt në nivelin e performancës vjetore të korporatës, etj.

Rreziku i çmimeve



Megjithëse KEK ka një strukturë të thjeshtë të shitjes sa i përket energjisë, varësia e produkteve të veta ndaj situatave globale është e lartë e diktuar nga kufizimet sasiore si burime të shtershme të energjisë. Viti 2023, megjithëse u shoqërua me pasojat e krizës energjetike, ai njëherësh edhe shënoi fillimin e stabilizimit të çmimeve në përgjithësi, dhe të atyre të energjisë në mënyrë specifike në bursat ndërkombëtare të

tregtimit. Kjo kishte ndikim të dyanshëm megjithëse me efekt të kundërt. Efekt pozitiv nga stabilizimi i çmimeve për importet dhe konsumatorët fundor. Ndërsa në shitjet e KEK për eksport, çmimi ishte më e ulët për 63% si mesatare, por edhe sasia e energjisë në dispozicion ishte më e ulët për 40%. Kjo ka bërë që vlera e përgjithshme e të hyrave nga shitja e energjisë nga eksporti të bie me -78%, krahasuar me vitin 2022.

Eksporti	2023	2022	2021	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
Çmimi mesatar	74.2	202.2	77.6	-128	-63%
Sasia MWh	350,449	580,660	747,831	(230,211)	-40%
Vlera	26,003,316	117,409,452	58,031,686	(91,406,136)	-78%

Burimi i të dhënave Departamenti i tarifave dhe çështjeve Rregullative KEK.

Nga Maji i vitit 2013, KEK nuk importon energji elektrike për të mbuluar deficitin në bilancin energjetik të Kosovës, prandaj, ekspozimi ndaj rrezikut të mallit është i kufizuar vetëm në çmimet e eksportit të energjisë. Duhet të ritheksohet se të hyrat e energjisë nga eksporti gjatë vitit 2022 ishin të hyra të jashtëzakonshme si rrjedhojë e krizës energjetike.





Po ashtu, gjatë vitit 2023, për shkak të efekteve përcjellëse të pandemisë Covid -19 dhe krizës energjetike, KEK nuk ka ndryshuar çmimin për blerësit vendor, me qëllim të vetëm, lehtësimin e barrës së çmimeve ndaj konsumatorëve fundor të energjisë elektrike. Respektivisht, çmimet për USS janë 29.5 €/MWh, ndërsa për mbulimin e humbjeve janë 36 €/MWh. Pritjet janë që KEK të ndryshoj këtë çasje përgjatë vitit 2024.

Aftësia negociuese

KEK vazhdon të ketë strukturën e njëjtë të partnerëve, dhe afërsisht shitjet janë kryesisht të orientuara drejt pak blerësve. E lidhur edhe me qëllimin e vet si kompani, KEK synon të ofroj çmime të ulëta për blerësit e vet në mënyrë që këto çmime të ulëta të transferohen tek blerësi fundor në vend. Sikurse dihet tashmë, raportet kontraktuale me blerësit kryesor të energjisë në vend, janë të rregulluara me marrëveshjet për shitjen me shumicë të energjisë mes palëve KEK tek KESCO. Duke qenë se këto marrëveshje obligojnë KEK për nominimin e sasisë së prodhuar tek këta dy Operator dhe pjesën e mbetur (kryesisht prodhimi gjatë

natës) nga energjia e eksporton, ato e limitojnë aftësinë e KEK në negocimin e çmimeve të favorshme të shitjes të cilat do ti mundësonin KEK sigurimin e burimeve të brendshme të mjaftueshme për realizimin e investimeve të planifikuara afatgjata. Në mos ndryshimin e çmimeve të furnizimit me shumicë nga ana e KEK gjatë vitit 2023 ka ndikuar edhe situata e krizës energjetike dhe qëllimi që të mos ndikohen konsumatorët fundor për çmimet e shitjes me shumicë për USS dhe Humbjet në rrjet. Megjithatë, KEK vazhdon të shoh të nevojshme rritjen e çmimit të energjisë në përshtatje me obligimet e pritura që KEK ka karshi objektivave të veta për stabilitetin e prodhimit të energjisë dhe detyrimeve të pritshme ndaj ambientit. Të dhënat e paraqitura në grafikonet e mëposhtme dhe në tabelë, pasqyrojnë transferin e energjisë së prodhuar nga KEK në tregun e energjisë sipas destinimit. Nga kjo, vërehet ndikimi i kësaj gjendjeje në negocimin e çmimeve të energjisë nën kushtet e numrit të vogël të blerësve dhe specifikave të korporatës në shitjen e energjisë:



Energjia - MWh	2023	2022	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi ne %
KESCO	4,158,233	4,167,421	-9,188	-0.2%
KEDS	384,789	571,925	-187,136	-32.7%
KOSTT	45,958	70,524	-24,566	-34.8%
Eksporti	350,449	580,660	-230,211	-39.6%
TOTAL	4,939,429	5,397,577	-458,148	-8.5%

Përfshirë energjinë e marr nga KESH
Burimi i të dhënave Departamenti i tarifave dhe çështjeve Rregullative KEK.

Rreziku i kreditimit

Edhe gjatë vitit 2023, megjithëse në nivele dukshëm më të ulëta, KEK –u ka vazhduar të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut të kreditimit si rrjedhojë e aktiviteteve të veta të shitjes, kryesisht nga vonesat në mbledhjen e detyrimeve nga KESCO dhe KEDS, të shkaktuara fillimisht nga Pandemia COVID-19, nga ana e konsumatorëve si rrjedhojë e kufizimit të lëvizjes, mbylljes së ekonomisë në periudhën Mars- Qershor 2020, e vazhduar me problemet e krijuara nga Kriza energjetike dhe rritja e çmimeve të fund vitit 2021 dhe e

vazhduar përgjatë vitit 2022 dhe 2023, ka shkaktuar vonesa në pagesën e faturave ndaj KEK, duke u reflektuar me aplikimin e kamatë vonesave.

- Rritja e llogarive të arkëtueshme, si rrjedhojë e krizave të fundit u bënë një shqetësim për sektorin e energjisë në Kosovë. Llogaritë e arkëtueshme, të paraqitura me vlerën neto të realizueshme në vitin 2023 janë zvogëluar në € 57.7 milion nga € 77.4 milion sa ishin në fund të vitit 2022. Këtu ndikimin kryesor ka zvogëlimi në LLA nga konsumatorët vendor të energjisë elektrike me pagesat për faturat e prapambetura, duke e zvogëluar këtë zë të pasqyrave financiare për 25% në 2023 krahasuar me 2022. Po ashtu, në këtë zë ndikim të madh kishte edhe rritja e interesit të arkëtueshme (i cili në vlerë më të madhe buron nga aplikimi i interesit në vonesën e pagesës së faturave nga KESCO dhe KEDS) për vonesën në pagesë të faturave të energjisë të shitura në vend tek partnerët kryesor të KEK. Kjo gjendje ka vazhduar përgjatë 2022 dhe 2023, përkundër përpjekjeve për menaxhimin e situatës:

	Shtator'23	Tetor'23	Nëntor'23	Dhjetor'23	Total pa interes	Interesi për Mars 2020 - Gusht 2021	Total deri në Janar 2024
KESCO	Fatura për Energji	-	4,698,958.82 €	11,361,945.06 €	14,585,476.14 €		30,646,380.02 €
	Interesi i Akumuluar	74,563.51 €	72,175.59 €	100,004.07 €		1,062,715.06 €	7,636,777.76 €
KEDS	Fatura për Energji				1,399,563.36 €		1,399,563.36 €
	Interesi i Akumuluar					194,718.46 €	381,338.90 €
Total Obligimi KESCO dhe KEDS		74,563.51 €	4,771,134.41 €	11,461,949.13 €	15,985,039.50 €	32,045,943.38 €	1,257,433.52 €
							40,064,060.04 €

MASAT: Megjithëse, vërehet një trend i zvogëlimit të borxhit, edhe gjatë vitit 2023 kishte vonesa në pagesën e rregullt të faturave. Për këtë çështje janë mbajtur disa takime dhe janë përcjell shkresa dhe komunikime lidhur me trajtimin e këtij borxhi. Divizioni Financiar ka përcjell lëndët (faturat dhe konfirmimet nga KEDS dhe KESCO) në zyrën Ligjore për trajtim përmes rrugës së arbitrazhit, si zgjidhje e paraparë në marrëveshjen kontraktuale. Për këtë rrezik, KEK-u ka njoftuar ZRRE dhe Aksionarin.

- Lidhur me eksportin e energjisë, kompania ka marr masa për transferin e rrezikut të kreditimit të shitjes së eksporteve përmes mbulimit të shitjeve me garancione të përmbushjes, dhe sipas kërkesës së tregtarëve, nga viti 2022 e tutje, KEK ka lejuar edhe mbulimin e tregtimit të energjisë me depozita në para në llogaritë e KEK. Po për minimizimin e rreziqeve të kredisë, shitjet realizohen strikt sipas rregullave të aprovuara nga ZRRE dhe me operatorë të licencuar.
- Rreziku i kredisë për para dhe ekuivalentë të saj konsiderohet i vogël, pasi palët janë banka me reputacion dhe në përgjithësi sektori bankar në Kosovë konsiderohet me stabilitet të lartë. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë pasqyrohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Rreziku nga kthimi në investime

Duke qenë se investimet financiare jo-qarkulluese, përbëjnë 26% Të total aseteve jo-qarkulluese Më 31.12.2023, me qëllim uljen e nivelit të rrezikut, KEK duhet jetë i kujdesshëm në diversifikimin maksimal të portofolios së investimeve, duke minimizuar rrezikun e kthimit nga investimet. Duke qenë se total

investimet financiare përfshijnë 33.9% në total vlerën e aseteve të KEK, investimet financiare duhet të realizohen përmes rregullores së investimeve dhe analizës financiare të rrezikut të portofolios, e cila duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Kosovë.


Rreziqet e likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lidhet me aftësinë e KEK për të gjeneruar flukse hyrëse të parasë të mjaftueshme për të shlyer detyrimet e veta afatshkurtra. Këta tregues financiarë monitorohen dhe raportohen periodikisht tek Bordi, aksionari dhe palët e interesit, dhe në bazë të raporteve (normave) të shpalosura në vijim, në afatshkurtër KEK nuk parasheh të ballafaqohet me rreziqe likuiditeti.

- Përkundër rritjes së llogarive të arkëtueshme në vitet e fundit si pasojë e Pandemisë Covid 19 dhe krizës energjetike, KEK ka një stabilitet në likuiditet e vërejtur edhe nga treguesit kryesorë të paraqitur në tabelën më poshtë. Megjithatë, paraja e gatshme është zvogëluar me 50%, kjo kryesisht si rrjedhojë e rritjes së investimeve financiare të KEK në depozita afatshkurtra (deri në 1 vit) me € 24.6 milion krahasuar me vitin paraprak dhe investimet afatshkurtër në letra me vlerë € 34.9 milion.
- Duke qenë se KEK ka pasur një nivel të lartë likuiditetit, kjo edhe si rrjedhojë e mos realizimit të disa nga projektet kryesore investive të cilat janë shtyrë për vitet vijuese, për shkaqe të sqaruara në këtë raport, duke ulur nivelin e kërkesave për daljen e parasë së gatshme por edhe si rrjedhojë e rritjes së çmimit të energjisë për eksportet, niveli i kapitalit punues, sipas gjendjes më 31 Dhjetor 2023, është rritur në 183.6milion, nga € 171.6 milion më 2022.
- Rritja e normës rrjedhëse (2023: 4.68), është tregues i një pozicioni më të fortë likuiditeti, ku krahasuar me vitin paraprak (2022: 3.29) kompania mban më shumë aktive qarkulluese në raport me detyrimet e saj afatshkurtra sesa në vitin e kaluar. Ky raport është kritik për vlerësimin e stabilitetit financiar afatshkurtër të kompanisë. Një raport më i lartë aktual sugjeron që kompania është e pozicionuar më mirë për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurtra pa pasur nevojë të shesë asete ose të sigurojë financime shtesë.
- Si rrjedhojë e investimeve financiare, Testi i Shpejt (Acid test ratio 2023: 4.29) është rritur krahasuar me vitin paraprak (2022: 3.01), çka në afatshkurtër tregon se kompania është e pa ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit dhe të aftë të shlyej shpejt detyrimet e veta. Në këtë normë ka ndikuar ulja rritja e Aseteve qarkulluese ndërkohë që inventari është zvogëluar si dhe zvogëlimi i llogarive të pagueshme afatshkurtër.
- Më poshtë tregues kryesor financiar:

Raportet/normat likuiditetit	2023	2022	2021	2020
------------------------------	------	------	------	------

Paraja e gatshme në €'000	48,365	97,140	112,517	67,929
Neto kapitali punues në €'000	183,630	171,609	139,127	94,511
Borxh/ekuitet	0.31	0.41	0.67	0.85
Norma rrjedhëse	4.68	3.29	3.87	3.77
Acid test	4.29	3.01	3.45	3.19
EBITDA në '000€	64,190	164,988	113,921	72,940



Rreziqet operative

Janë rreziqe me nivel të mesëm operativ të vendimmarrjes. Lidhen me probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me - me mungesën e burimeve njerëzore si dhe mosha mesatare e lartë e punëtorëve, probleme në rrjetin e furnizimeve dështime në realizimin e kontratave, mosfunksionim i pajisjeve kryesore, gabime të operatorëve /dëme aksidentale, vjedhja dhe mashtrimet, etj (shih regjistrin e rreziqeve).

Rreziku i mos-realizim të buxhetit

Megjithëse KEK ka rritur vit pas viti, aftësinë e vet për të investuar në asete fikse, si një nevojë tashmë e urgjente për të rritur stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike, ekzistojnë një sërë faktorësh që e rrezikojnë përparimin e shpejtë në këtë drejtim , dhe që lidhen kryesisht me një orientim strategjik më të qartë, përkundër faktit, që nevoja për investime në KEK mbetet shumë e lartë.

Kjo gjendje e rrit nevojën e KEK të krijimit sa më të shpejtë të një profili të rrezikut e cila me fillimin e aplikimit të procedurës në vitin 2020, për shkak të situatës së pandemisë, situatën politike dhe së fundmi me krizën energjetike ka krijuar pasiguri shtesë nga faktorë të jashtëm duke e bërë edhe më të rëndësishëm forcimin e nevojës për menaxhim më të mirë të rreziqeve me qëllim realizimin e objektivave të korporatës.

Viti 2023, mund të jetë faza e fundit e krizës energjetike. Megjithatë, periudhat e krizave nga pandemia dhe kriza energjetike, është një periudhë tranzicioni e cila ka shkaktuar ndryshime strukturore të kostove dhe shpenzimeve. Rritja e inflacionit kryesisht nga në çmimet e karburanteve, kemikaleve, ndryshimet e çmimeve të metaleve dhe të tjera, ka reflektuar në rritjen e kostove të prodhimit për KEK.

KEK ka disa rreziqe kryesoret të cilat përmbledhtas adresohen në proces edhe pse të limituar në aktivitete, që ndërlidhen me realizimin e buxhetit 2024-2026, janë:

- Megjithëse Pandemia shkaktoi çrregullime të mëdha në të gjithë ekonomië e vendit, sektori i minierave dhe ai i energjisë ku operon KEK ka mbajtur një nivel të lartë të realizimit të planit të prodhimit. Efektet e krizës energjetike ose krizave të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në çmimet e energjisë pritet të kenë efekt më të madh në realizimin e planeve buxhetore dhe afariste të KEK.
- Vjetërsia e kapaciteteve aktuale gjeneruese, bënë që mbajtja e prodhimit të energjisë në sasinë e planifikuar për ta mbuluar gjithë kërkesën vendore është e pasigurt. Në këtë pikë statusi i TCB është i qartë dhe investimet aty janë të definuara ndërsa mbetet për tu sqaruar orientimi afatgjatë në TCA me strategjinë e energjisë e cila është në proces. Me këtë varet edhe realizimi i buxhetit të KEK për bllokun A3.
- Mosrealizimi i investimeve strategjike në ndërrimin e elektro-filtrave në TCB të planifikuara të realizohen sipas planit të paraparë për vitin 2020 janë shtyrë fillimisht për vitin 2021/2022 pastaj janë shtyrë sërish për vitet 2024/2025 dhe aktualisht për 2025/2026.
- Shtyrja e projektit të Elektrofiltrave ka ndodhur për të disatën herë me radhë. Fillimisht, realizimi i këtyre projekteve është i ndërlidhur me projektin e delatimeve, i cili ka përfunduar gjatë vitit 2023. Megjithatë, gjatë vitit 2023 kemi shtyrje të këtij projekti për vitin 2025/26, duke rezultuar me nevojën për ndryshimin e planifikimeve buxhetore të KEK dhe duke shfaqur probleme me kontratat ekzistuese të lidhur me projektet që duhet të realizohen në kohën e njëjtë me donacionin e BE. Kjo në disa raste (në TCB) ka shkaktuar edhe vonesa në realizimin e investimeve kapitale të planifikuara, të cilat edhe pse të kontraktuara, për shkak të nevojës për ndalesa të gjata të njësive gjeneruese për realizim nuk kanë mundur të realizohen këtë kohë
- Mosrealizimi i investimeve kapitale mbetet një nga rreziqet kryesore që ndikon në stabilitetin e prodhimit. Edhe gjatë vitit 2023 ka pasur ndryshime të shpeshta të BVEE si rrjedhojë problemeve nga ndalesat e paplanifikuara si dhe nga vonesat në realizimin e investimeve në njësitë kryesore të prodhimit.

- Ndryshimet e njëanshme të taksave/tarifave nga ZRRE, me aplikimin e tarifave për MWh të prodhuar për çasjen në rrjetin e KSTT –it, duke e rritur pasigurinë e KEK për planifikimet e veta buxhetore nga papara shikueshmëria e vendimeve nga këto institucione.
- Me gjithë rekrutimet e stafit në disa pozita gjatë vitit 2023, pensionimet e kuadrove me përvojë dhe vonesat në zëvendësimin e tyre, si dhe ndryshimet e shpeshta në KEK, bëjnë që të ketë vonesa në realizimin e projekteve ose edhe në buxhetin vjetor, rrjedhimisht ndikon në arritjen në kohë dhe me cilësi të objektivave.
- Pafuqia negociuese , është një element që vjen nga MFSH (BSA) me KEDS dhe KESCO që po ashtu ka ndikuar në vonesat e theksuara në inkasimin e energjisë elektrike dhe në pafuqinë negociuese të KEK në ndryshimin çmimit të energjisë elektrike të shitur brenda vendit.
- Dështimet në lidhjen e kontratave për shitjen e thëngjillit të planifikuar në pjesën e të hyrave për vitin bën që KEK të mos jetë në gjendje të realizoj kapacitetet e veta për rritje të burimeve financiare. Për vitin 2024 janë paraparë të realizohen 500k ton shitje të thëngjillit.

Rreziqet e përputhshmërisë

Këto rreziqe përfshijnë detyrimet e drejtorëve dhe zyrtarëve të lartë të korporatës për përputhshmërinë me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme si dhe funksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme, të cilat ndikojnë në uljen e rreziqeve kritike gjatë 2024, si: detyrimet për raportime Rregullative dhe respektimi i kërkesave ligjore, detyrimet për mbrojtjen nga ndotja atmosferike e tokës/ujit dhe ajrit, mbrojtja e shëndetit dhe siguria e punëtorëve, detyrimet ligjore ndaj palëve të treta, si dhe kontestet nga raportet kontraktuale, përfshirë rastet e arbitrazhit, detyrimet për kontestet ligjore nga punëtorët, detyrimet për trajtimin e asbestit, rreziqet e katastrofave natyrore, etj.

- Në Nëntor 2020 KEK ka pranuar raportin përfundimtar për vlerësim të riskut, nga kompania konsulentë e angazhuar për të siguruar informata dhe specifika lidhur me tregjet ekzistuese të sigurimeve dhe mundësitë e sigurimit të asetëve qenësore të KEK-ut nën kushtet e tyre fizike. Kjo çështje është diskutuar disa herë me BpD gjatë vitit 2021. Ky raport bazohet në kushtet dhe praktikën e vëzhguara dhe informacionin e vënë në dispozicion në kohën e studimit vlerësues. Ky studim përfshiu një rishikim të gjendjes së ndërtesave, operacioneve, rreziqeve natyrore dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri duke përfshirë sigurinë e jetës. Ai gjithashtu përfshiu një rishikim të kontrolleve administrative të tilla si inspektimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri, dëmtimet e këtyre sistemeve dhe planifikimi i emergjencave të mbrojtjes nga zjarri.

- Gjatë studimit në terren, rreziqet (në raportin e sipërpërmendur) janë konstatuar të jenë brenda konceptit të zbutjes së rrezikut. Objektet e shqyrtuara gjatë studimit konsiderohen në gjendje mesatare të krahasuar me impiante shtetërore që përdorin teknologji dhe kane moshe të ngjashme. Megjithatë, për shkak të moshës, këshillohet fuqimisht që një rehabilitim gjithëpërfshirës dhe domethënës duhet të planifikohen investime në të gjithë impiantet kyqe.
- Në këtë raport janë dhënë edhe rekomandimet specifike për formulimin (ose përmirësimin ekzistues) të Programeve të Menaxhimit si dhe sigurimin (ose rritjen) e masave mbrojtëse fizike për të kontrolluar rreziqet specifike kryesisht të analizuara nga pikëpamja dhe fushëveprimi i këtij raporti.

*Me qëllim të dhënies së informacioneve objektive për menaxhimin e këtij rreziku dhe që (në rast inicimi aktivitetit) të mundësojnë re-siguresit kredibil të ofertojnë për shitje të polices së sigurimit, janë kontraktuar shërbimet për vlerësim të riskut në KEK gjatë 2020. KEK ka diskutuar këtë çështje me bordin e drejtorëve dhe në mbledhjen vjetore me Aksionarin në Nëntor 2021. Si konkluzion nën kushtet kur ne jemi të obliguar të bëjmë investime që ndikojnë në stabilitet të pajisjeve prodhuese në të gjitha divizionet, për shkak të vlerës së lartë të parashikuar të primit dhe kufizimeve të tregut të sigurimeve, **KEK nuk ka planifikuar të bëjë sigurimin e aseteve**. Ky rrezik edhe për shkak të kostove që tejkalojnë përfitimet për menaxhimin e tij ende mbetet i njëjtë edhe në vlerësimet për vitin 2024.*

- Gjatë vitit 2023 KEK ka identifikuar të nevojshme vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës, megjithatë me vendim menaxherial kjo çështje nuk është proceduar, me arsyetimin objektiv se ndërlidhet me procesin e rishikimit funksional të skemës organizative. Megjithatë kjo mbetet një rrezik permanent për KEK, i vlerësuar edhe si detyrim ligjor i punëdhënësit sipas Ligjit 04/L-161. Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës do të ndihmonte në përshtatjen e rregulloreve dhe politikave të sigurisë, të cilat do të përcaktonin masat parandaluese, duke ulur rrezikun për aksidente në vendet e punës të gjitha divizionet e KEK-ut.

Masat për menaxhimin e rreziqeve

Menaxhimi i rreziqeve është proces i vazhdueshëm dhe kërkon zbatimin e masave të parapara nga vet bartësit e rreziqeve, si personat më kompetent për eliminimin e situatave të pafavorshme. Këto masa dhe afatet janë të përshkruara në regjistrin e rreziqeve për vitin 2024.

- Rreziqet strategjike- niveli i vendimmarrjes është i Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të lartë të korporatës. Kërkohet monitorim i shtuar për zbatimin e kërkesave për eliminimin e rreziqeve të identifikuar në këtë kategori.
- Rreziqet Financiare- përgjegjës Drejtori Financiar dhe Drejtori Menaxhues, me përkrahjen e BtD për vendimet e mëdha. Kërkojnë aktivitete periodike të listuara tek identifikimi dhe regjistri i rreziqeve.

- Rreziqet e përputhshmërisë- niveli i menaxhmentit dhe përgjegjësi e të gjithë drejtuesve në të gjitha nivelet, që të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme duke ndikuar në funksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme, të cilat pastaj ulin nivelin kritik të rreziqeve 2023. Ky nivel i rreziqeve rritet me rritjen e qarkullimit të stafit në pozita të ndryshme duke qenë se kërkohet kohë deri në aftësimin profesional për të zvogëluar ekspozimin ndaj rreziqeve të përputhshmërisë.
- Rreziqet operative - niveli i vendimmarrjes për menaxhimin është i menaxhmentit. Zvogëlimin e këtij grupi të rreziqeve, varen shumë nga realizimi i buxhetit. Në vitin 2024, sipas të dhënave nga departamenti i Buxhetit, realizimi i buxhetit ishte i ulët:

Në '000€	Buxheti sipas rrjedhës se parasë 2023		Buxheti sipas rrjedhës se parasë 2022	
	Kapitale	Operative	Kapitale	Operative
Planifikim	91,972	163,422	54,690	251,026
Realizim	25,892	138,866	6,747	163,180
Variacioni në %	-71.8%	-15.0%	-87.7%	-35.0%

Duke qenë se investimet kapitale, janë të lidhura me stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe të thëngjillit, mos realizimi i tyre në masë optimale shkakton rritje të rrezikut të operimeve dhe pasiguri në realizimin e objektivave operative dhe atyre financiare të korporatës, si dhe ndikon në rritjen e shpenzimeve të paplanifikuara. Masat, që varen nga KEK, për të minimizuar rrezikun në mos realizim të buxhetit 2024 mbesin të njëjta dhe, ndër të tjera, janë:

- Inicimi me kohë i kërkesave për blerje, trajtimi me kujdes të shtuar dhe profesional i specifikimeve teknike dhe kërkesave administrative, hulumtim intensiv i tregut, trajnime për stafin e involvuar në blerjet dhe menaxhimin e kontratave etj,
- Zbatimin me përpikëri të standardeve operues të punës dhe kërkesave teknike etj.,
- Inicimi i konkurseve për angazhimin e punëtorëve dhe menaxhimi me kujdes i shpalljeve publike për angazhimin e kuadrove me kohë për përmbushjen e kërkesave urgjente për staf profesional dhe jo vetëm.

RAPORTIMET SHITESË PËR AKSIONARIN

Qeverisja korporative

KEK operon me Bordin Drejtues si organin më të lartë vendimmarrës në korporatë. Përgjegjësitë e qeverisjes korporative bien mbi këtë organ dhe janë të rregulluara me ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera nënligjore. Bordi Drejtues i KEK Sha është organ i pavarur dhe profesional, i zgjedhur përmes procedurave ligjore dhe transparente nga ana e aksionarit. Ai funksionon në përbërje të plotë dhe drejton ndërmarrjen e cila operon në tregun e energjisë si ofrues i të mirës publike nën rregullat e qeverisjes korporative në përputhje me ligjet dhe aktet tjera ligjore.

Bordi është përgjegjës për përcaktimin e strategjisë së Korporatës dhe orientimet afatgjata të biznesit, drejt rritjes së vlerës së interesit të aksionarit në kompani. Funksionet e bordit përfshijnë krijimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen, e strategjisë së korporatës, duke marrë për bazë edhe analizën e rreziqeve me të cilat kërcënohet mos realizimi i pritjeve financiare dhe jo financiare përfshirë rreziqet sociale, mjedisore, ambientale të reputacionit dhe etikes së biznesit.

Përveç që vendos për strategjinë e biznesit, bordi ka për detyrë zgjedhjen dhe monitorimin e menaxhmentit të lartë të kompanisë, bartjen e autorizimeve dhe monitorimin. Gjatë vitit 2023 këtë funksion, bordi e ka ushtruar në përzgjedhjen e Drejtorit Financair të korporatës, suspendimin e krye shefit ekzekutiv dhe plotësimin të pozitës me ushtrues detyre, si dhe në shkarkimin e sekretarit të korporatës dhe plotësimin të pozitës me UD.

Rolin dhe detyrat e veta mbikëqyrëse Bordi i Drejtorëve e kryen përmes mekanizmave të ndryshëm. Për këtë qëllim kompania ka të themeluar komitetin e Auditimit i cili vepron në kuadër të Bordit të Drejtorëve në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe me praktikat më të mira të qeverisjes korporative.

Gjatë vitit 2023, bordi ka marr një sërë vendimesh për korporatën duke përfshirë aprovimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për Vitin 2022, Raportin Vjetor të KEK për 2022, raportin e Rreziqeve për 2023, Rishikimin e Buxhetit për 2023 si dhe aprovimin e buxhetit afatmesëm për periudhën 2024-2026, aprovimin e Raporteve periodike dhe monitorimin e performancës së korporatës, një sërë vendimesh për ri-alokime të mjeteve buxhetore në përputhje me rregulloret e brendshme, dhe një sërë vendimesh të tjera të karakterit strategjik. Në marrjen e këtyre vendimeve bordi ka shfrytëzuar për konsultim edhe Zyrën e Auditimit të Brendshëm në kapacitetet e saja për siguri dhënie përmes opinionëve për procedurat dhe rregulloret që është dashur që të aprovohen në BD përmes Komisionit të Auditimit.

Gjatë vitit 2023 Bordi i drejtorëve të KEK, me synim rritjen e kontrolleve të brendshme dhe përgjegjësinë e punonjësve të korporatës ka aprovuar rregulloret dhe procedurat në vijim:

- Politikat e IT
- Procedurës së tregimit të energjisë elektrike
- Kodin e Punës
- Procedura për përgjegjësitë disiplinore
- Procedura për investimin e mjeteve financiare në afatizime bankare dhe letra me vlerë

Së fundmi, bordi i drejtorëve ka marr edhe vendime të tjera strategjike në përputhje me detyrat dhe përgjegjësit e tij në kuadër të qeverisjes korporative si: Angazhimin e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare, aprovimin për rritjen e pagave për punëtorët si dhe ndarjen e bonuseve për punëtorët e KEK në bazë të performancës vjetore të realizuar nga korporata, etj.

Vendime të tjera lidhur me përgjegjësitë sociale kanë të bëjnë me sponsorizimin gjeneral të konferencës së mirënjohur për energjinë CIGRE II, dhënien e 250 ton thëngjill donacion për ngrohje për shkollat e Komunës së Obiliqit, dhëni e donacionit për shërim jashtë vendit etj.

Kultura e menaxhimit të rrezikut

Kultura e Menaxhimit të Rrezikut në Ndërmarrje (ERM) është një komponent i rëndësishëm i ndërgjegjësimit për menaxhimin pro aktiv të rrezikut në të gjitha nivelet e organizatës si dhe jetik i një strategjie gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut. Ajo nxit një mjedis ku punonjësit jo vetëm inkurajohen por edhe pritët të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet brenda fushave të tyre të përgjegjësisë. Kjo kulturë ndërtohet mbi një bazë të komunikimit të hapur, ku diskutimi i rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme është pjesë e rrjedhës së punës së përditshme, duke siguruar që menaxhimi i rrezikut të mos jetë i izoluar nga, por i integruar në proceset e vendimmarrjes. Një kulturë efektive ERM promovon përgjegjësinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm, duke mundësuar organizatat të parashikojnë dhe të zvogëlojnë rreziqet më efektivisht, duke mbrojtur kështu pasuritë, reputacionin dhe interesat e palëve të interesit.

Për këtë qëllim roli i Auditimit të brendshëm në rishikimin e procesit të brendshëm të menaxhimit të rrezikut është i nevojshëm edhe për të rritur kulturën organizative për këtë proces. KEK gjatë vitit 2023 kishte auditime të pjesshme të procesit, kryesisht nën Auditimin e vendimeve të BtD. Megjithatë planifikohet, që pas rishikimit të planit vjetor të ZAB ose me kërkesë të veçantë, të auditohet procesi i menaxhimit të rrezikut në KEK.

Përkrahja për komunitetin

Përkrahja për komunitetin - gjatë vitit 2023 nuk janë financuar projektet për komunitetin, kjo për arsye se projektet janë publikuar më shumë se njëherë dhe për disa nuk ka pasur fare oferta ndërsa për disa ofertat kanë qenë të pa përgjegjshme. Ndërsa, KEK si zakonisht ka vazhduar përkrahjen komunitetin dhe institucioneve të sigurisë në vend me punë dhe pajisje.

Funksionimi i kontrolleve të brendshme

Sistemi i kontrolleve të brendshme dhe ndarja e detyrave

Kontrollet e brendshme janë mekanizma e vendosura nga organizata në proceset e veta operacionale dhe financiare, të dizajnuara me qëllim që të sigurohet integriteti e raportimin financiar, përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret, dhe për të siguruar operacionet efektive dhe efikase. KEK ka të implementuara rregullore dhe procedura që krijojnë sisteme dhe procese të cilat mundësojnë arritjen e qëllimeve të kontrollit të brendshëm. Këto sisteme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: menaxhimin e rrezikut, ambientin dhe aktivitete të kontrollit, informimin dhe komunikimit, shmangien e konfliktit të interesit, ndarjen e detyrave dhe monitorimin, siguria fizike dhe dixhitale përputhshmërinë me ligjet dhe raportimin sipas rregullave, detektimin e rreziqeve nga mashtrimet dhe keqpërdorimet et.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar është jetik për forcimin e qëndrueshmërisë dhe performancës së organizatës për të siguruar që ndërmarrja mbetet në treg në afatgjatë. Kjo përmes vendimmarrje më të mirë, shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paratë e cila sigurohet përmes proceseve kualitative të buxhetimit, menaxhimit të mirë të flukseve të parave dhe raportimit financiar që shërbejnë si bazë e sigurt për vendimmarrësit. Menaxhimi financiar nënkupton edhe vendimmarrjen për investime dhe menaxhimin e rrezikut për të harmonizuar qëllimet financiare me objektivat organizative, ndërsa kontrolli i kostove dhe menaxhimi i strukturës së kapitalit përcaktojnë edhe optimizimin e përdorimit të resurseve dhe financimin. Po ashtu përfshinë sigurimin që stafi, asetet dhe buxhetet përdoren në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Po ashtu, planifikimin e punës dhe atë financiar, buxhetimin dhe raportimin dhe përfshinë parimet e transparencës dhe llogaridhënies përmes të cilave individët e pranojnë përgjegjësinë për veprimet e tyre. Gjatë vitit 2023, aktivitetet financiare janë rritur kontrollet me hartimin e procedurave për

investimet financiare dhe zhvillimi i aktiviteteve të shumta në këtë drejtim. Aktivitetet janë të rregulluara me kodin e punës, rregulloren për aprovim buxheti dhe kontroll të shpenzimeve, rregulloren për menaxhim të rrezikut, si dhe rregullore dhe procedura të tjera operative të implementuar në përputhje me ligjet e aplikueshme në vend.

Sfidat në menaxhimin financiar

Përgjatë vitit 2023, janë kërkuar ose bërë rishikim i proceseve për përmirësim të menaxhimit dhe janë rregulluar disa funksione të brendshëm me qëllim arritjen e objektivave të menaxhimit financiar të korporatës, duke respektuar kërkesat ligjore dhe me nivel të përshtatshëm të etikës profesionale.

Bazuar edhe në Letër Menaxhment 2022 të ZKA, Korporata Energjetike e Kosovës është e ekspozuar edhe gjatë vitit 2023, ndaj mundësisë së gabimeve të procesimit dhe të raportimit financiar, ku në disa raste, janë identifikuar gabime në proces të regjistrimeve kontabël si rrjedhojë e trajtimit kontabël, procesit të rivlerësimit siç është kërkuar nga ZKA ose mos barazimeve financiare me palët e treta. KEK gjatë vitit 2023 ka kryer disa aktivitete në drejtim të trajtimit të këtyre gjetjeve dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme në financat e korporatës. Po ashtu janë zhvilluar aktivitete lidhur me futjen në përdorim të inventarit në ERP, ndër të cilat pastrimi i listave të inventarit dhe rifreskimi i kodeve të artikujve barazimet me depot etj. Ku sfidë mbetet mungesa e stafit, mungesa e trajnimeve, mungesa e mirëmbajtjes së ERP, etj.

Po ashtu, rishikimi funksional i skemës organizative të KEK, ka shkaktuar vonesa në implementimin e suksesshëm të komplet sistemit ERP në të gjitha modulet (ka ende aktivitete për futjen në përdorim të modulit të blerjeve dhe inventarit) e që është nevojë e KEK për avancim dhe rritje të performancës, e shprehur në draft- raportin e konsulentit të pavarur për rishikimin funksional të skemës organizative të KEK, i cili ka rekomanduar edhe avancime dhe modernizime të tjera në fushën e IT. Këto përmirësime kanë si synim zvogëlimi e gjasave të gabimeve të procesimit si dhe rritjen e transparencës përmes ofrimit të informatave të sakta dhe në kohë reale që mundësojnë edhe kontroll efikas dhe gjithëpërfshirës të regjistrimeve, transaksioneve dhe raporteve financiare. Megjithatë, rreziqe evidente mbesin në këtë kontekst si rezultat i mungesës së stafit dhe problemeve të lidhura me çështje të kompetencës së stafit ekzistues gjatë vitit 2023.

Zyrtari i për shmangien e konfliktit të interesit

Në kuadër të aktiviteteve për shmangien e konfliktit të interesit, gjatë vitit 2023, në bazë të informatave të pranuar ose inicimeve nga zyrtarë kompetent, janë zhvilluar 3 procedura për verifikimin e ekzistencës së rasteve të mundshme të konfliktit të interesit. Që të tria rastet kanë të bëjnë me konkurset e punësimeve dhe nga to në dy raste si masë për parandalim konflikti, ka pas kandidatë të eliminuar nga gara si rrjedhojë e gjetjes së elementeve të mundshme të konfliktit të interesit. Për rikujtim, nga viti 2022 KEK ka emëruar një zyrtar për të kryer aktivitetet në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Zyra e Auditimit të Brendshëm në KEK është e themeluar në bazë të Ligjit 06/L-021 dhe Ligjit të Ndërmarrjeve Publike 03/L-087 si njësi e pavarur e Auditimit të Brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të udhëheqësit të subjektit të sektorit publik. Auditimi i Brendshëm ka pavarësi funksionale nga menaxhmenti pasi që i përgjigjet Komisionit të Auditimit të Bordit të Drejtoreve.

Sipas skemës organizative të Zyrës së Auditimit të Brendshëm (ZAB), të miratuar më datën 25.10.2022, e cila ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2023, janë të paraparë 19 auditorë të brendshëm duke përfshirë koordinatorin e zyrës së auditimit dhe Drejtorin e auditimit.

ZAB ka kryer auditime duke u bazuar në planin vjetor të aprovuar nga Komisioni i Auditimit të Brendshëm dhe në disa raste edhe me kërkesa të veçanta, të cilat mund të vijnë nga Komisioni i Auditimit, Bordi i Drejtoreve apo Menaxhmenti.

Gjatë vitit 2023, Auditimi i Brendshëm ka hapur gjithsej 31 raste, prej të cilave 25 kanë qenë të bazuara në planin vjetor kurse 6 janë kryer në bazë të kërkesës.

Gjatë kësaj periudhe Auditimi i Brendshëm ka arritur që të përfundoj 28 raste ku janë përpiluar draft raportet dhe pas mbajtjes së takimeve pajtuese, kanë kaluar në raporte finale, ndërsa 3 rast janë në proces të auditimit, dhe për shkak se kanë të bëjnë me monitorimin e regjistrimit të fund vitit, ato pritet të përfundojnë në fillim të vitit 2024.

			Rekomandime	
Numri i rasteve	Plan Vjetor	Kërkesë	Përmirësim Procesi	Masë Disiplinore
31	25	6	101	0

Gjate kësaj periudhe pos aktiviteteve të rregullta kemi pasur edhe bashkëpunime me organet rendit për trajtimin e rasteve të ndërlidhur me aktivitetet e ZAB, si dhe është asistuar në punën e Auditorit të ZKA.

Zyra Ekzekutive për Përputhshmëri Institucionale dhe Organizative (ZEPIO)

Në kuadër të kontrolleve të brendshme, për mbarëvajtjen operative dhe institucionale me vendim të BtD që nga viti 2014, operon edhe ZEPIO, si instrument i menaxhmentit brenda Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Aktivitetet kryesore të ZEPIO-s, lidhen me kontrollet parandaluese (ex-ante), të cilat kanë ngritur në mënyrë të konsiderueshme efikasitetin dhe efektivitetin në korporatë, duke u bërë thelbësore në mbrojtjen kundër sjelljeve të mundshme negative dhe neglizhencës. Gjatë vitit 2023, ZEPIO ka bërë inspektime në të gjitha divizionet dhe zyrat ekzekutive të KEK-ut, duke rezultuar në 35 raporte me gjithsej 159 rekomandime. Përpyekjet e ZEPIO ishin të fokusuara në sigurimin e përputhshmërisë ligjore nga fillimi i prokurimit deri te zbatimi dhe menaxhimi i kontratave, duke u përmbajtur rregullave të brendshme, Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacioneve të tjera përkatëse. Ajo kryen inspektime ad-hoc bazuar në informacionet nga terreni, kontrolle me udhëzim nga menaxhmenti i KEK-ut, kontrolle rutinë dhe vlerësime të planeve të investimeve dhe funksionimeve të departamenteve gjatë ekzekutimit të kontratave. Inspektimet e ZEPIO-s ishin hetimore, parandaluese, rutinore dhe udhëzuese. Një aspekt i veçantë është puna e pavarur e Zyrtarit Për Sinjalizim brenda ZEPIO-s, puna e të cilit gjatë vitit 2023 ka rezultuar me 13 raporte sipas rasteve të sinjalizimit, dhe të njëjtat janë raportuar tek autoritetet përkatëse.

Përmbledhja e të gjitha procedurave gjyqësore

Zyra Ligjore në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) trajton të gjitha çështjet ligjore përmes dy departamenteve: Departamentit Ligjor për lloje të ndryshme të kontesteve gjyqësore dhe Departamentit të kontratave pronësore dhe komerciale, duke përfaqësuar korporatën në të gjitha çështjet ligjore bazuar në legjislacionin në fuqi dhe normativën e përgjithshme të KEK-ut. Një rol të rëndësishëm është menaxhimi i mbrojtjes ligjore dhe regjistrimit të pronës së paluajtshme të KEK-ut, duke përfshirë pronat e njësisive të ndara (shoqëritë aksionare të formuara në pronën e KEK-ut) nga KEK dhe që tani janë në marrëdhënie kontraktuale.

Nga janari deri në dhjetor 2023, Zyra Ligjore ka regjistruar 202 padi të reja (civile, penale dhe ekonomike), me vlerë përafërsisht 2,199,229.06€, me 189 lëndë kundër KEK-ut. Në të njëjtën periudhë, ishin 246 lëndë (Gjykata e parë, e dytë dhe Supreme) me 157 aktvendime në favor të KEK-ut dhe 90 në favor të palëve. Janë ekzekutuar gjithsej 90 aktgjykime në vlerë prej 524,203,64€. Gjithashtu, janë mbajtur 610 seanca gjyqësore dhe janë përgatitur 329 parashtresa të ndryshme.

Departamenti i Pronës ka regjistruar 32 padi të reja (civile, penale dhe ekonomike) në vitin 2023, me vlerë totale të kontesteve të iniciuara nga KEK-u në 48,904.80€. Palët paditëse ndaj KEK nuk vendosin vlerat e

kontestit në propozimet e tyre fillestare, duke propozuar vlerësimin e ekspertit financiar gjatë procedurave gjyqësore. Në këtë kontekst ndaj KEK-ut gjatë vitit u paraqitën 30 raste.

Në segmentin e Aktgjykimeve/Aktvendimeve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë regjistruar gjithsejtë 33 lëndë (Shkallës së Parë, Dytë dhe Supreme) prej tyre 25 kanë rezultuar në favor të KEK-ut kurse 5 në favor të palëve dhe 3 lëndë janë kthyer në rivendosje si dhe 67 Aktvendime për veprime procedurale. Është vetëm një Aktgjykim që u ekzekutuan në vlerë prej 6,400.95 €.

Janë zhvilluar-caktuar 184 seanca gjyqësore, janë përgatitë nga KEK. sha 145 Parashtresa të ndryshme (Përgjigje në Padi, Ankesa, Prapësime etj).

Për procesin e shpronësimit të zonës 129 ha për shkaqe të gabimeve teknike të disa parcelave, janë në proces të shpronësimit edhe tetë (8) pronarë të afektuar me 27 parcela kadastrale në ZK- Sibovc, ZK- Shipitull dhe ZK – Leshkoshiq të gjitha këto Zona Kadastrale të Komunës së Obiliqit. Qeveria e Kosovës ka nxjerr vendim për procedim të mëtejshëm të shpronësimit dhe tani procesi është në vlerësim financiar të patundshmërive në Ministrinë e Financave dhe me nxjerrjen e vendimit përfundimtar të shpronësimit nga Qeveria e Kosovës përfundon kjo çështje procedurale e projekt elaboratit 129 ha. Departamenti i pronës në bashkëpunim me zyrtar nga departamenti i Injinerit dhe zyrtar nga departamenti i gjeodezisë Injinerike me kërkesë të Ministrisë së Financave e ka përgatitë incizimin, skicimin teknik për objekte banimi dhe objekte përcjellëse dhe zyrtarisht në dy kopje dhe në CD elaborati është proceduar për MMPH dhe për MF (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave).

Zyra Ligjore – Departamenti i Pronës, në bashkëpunim me Drejtorin e ZL dhe Sekretarin e Korporatës kanë përgatitur dosjen e tenderit për zhvendosjen e zonës së re prej 72 ha, për këtë zonë është vendosur që paralelisht të zhvillohet procesi i zhvendosjes me atë të shpronësimit, me qëllim të mos rënies në vonesë të marrjes në posedim të pronave në të cilat është planifikuar zhvillimi – avancimi i mihjes së re.

Zyrtarët e Departamentit të Pronës kanë bërë kërkesa për nxjerrjen e certifikatave pronësore në KK-Obiliq për projektin e zhvendosjes 72.04 ha, ku ja kanë siguruar Operatorit Ekonomik këto certifikata pronësore me Kopje të planit për fillimin e procedurës së zhvendosjes në këtë zonë. Po ashtu gjatë muajit Dhjetor zyrtarët e Departamentit të Pronës e kanë përcjellë incizimet në teren të Operatorit Ekonomik për projektin e zhvendosjes 72.04. ha, i cili ka përfunduar në tërësi, gjithashtu jemi në proces për ndryshimin e vijës së elaboratit (sipas propozimit të DPQ-së), ku parashihet të merret edhe një pjesë e parcelave sipas ndarjes fizike.

Zyrtarët e Departamentit të Pronës së bashku me Departamentin e Gjeodezisë së KEK, kanë bërë kërkesa pranë Komunës së F-Kosovës dhe Komunës së Obiliqit për ndarjen e parcelave sipas zonave kadastrale për projektin solar, ku këto kërkesa janë miratuar nga komunat përkatëse dhe është njoftuar zyrtari përgjegjës i këtij projekti në KEK.sha.

Transaksionet e Konsiderueshme

Gatë vitit 2023, KEK ka hyr në transaksione të konsiderueshme për kontrata publike të paraqitura në tabelën e mëposhtme. Kontratat e nënshkruara përfshijnë kontrata për punë, shërbime dhe furnizime operative dhe kapitale, të nënshkruara gjatë vitit 2023, për të cilat transaksionet kanë filluar ose janë në proces, pa marrë parasysh realizimin e tyre.

Kontratat e nënshkruara nga KEK me vlerë >500 mijë euro	Vlerat e kontrates ne vitin 2023
Liferimi dhe instalimi pllakës së presionit si dhe inspektimet e ndryshme për turbinën e presionit të ulet ne B2	626,580.00
Modernizimi i turbinave B1 dhe B2	56,522,000.00
Pllakat rrëshqitëse në PF- Kanalet e mullinjëve të thëngjillit	1,621,544.20
Blerja e shërbimeve për mbikëqyrjen e implementimit të projektit dizajni, furnizimi dhe kryerja e punëve lidhur me dilatatimet e kaldajave B1 DHE B2 NË TC KOSOVA B	628,425.00
LOT 1 Furnizim me Hidroksid Natrium (NAOH 45-50%)	526,458.41
Prodhimi, liferimi dhe implementimi i materialit shtesë dhe EXTRA shtesë në lidhje me dilatatimet e kaldajës B1 dhe B2	2,238,904.74
Mbështetje në mirëmbajtje të DCS-it në TC B për vitin 2023	519,204.00
Riparimi i ndërprerësit 24 kV të Gjeneratorit Elektrik në njësitë B1 dhe B2	1,386,245.16
Shamotimi izolimi tek kanalet riqarkulluese dhe pllakat rrëshqitëse në TC "Kosova B"	873,505.62
Furnizim me mazut	745,876.40
Furnizim me kamion transporti Damper	769,360.00
Rehabilitimi i kanaleve kryesore të gazrave nga EKO-ja deri te nxehësit e ajrit	877,051.52
Furnizimi me rula pajisje xehtare	1,105,288.88
Sigurimi shëndetësor për punëtorët e KEK sh.a.	2,441,456.64
Liferimi, montimi dhe lëshimi në punë i transformatorit 40 MVA 220 6.3 KV	981,101.01
Transporti i punëtorëve të KEK-ut relacioni Mitrovicë-Vushtrri	1,388,077.33
Gjithsejt	73,251,078.91

Raportet me KPMM dhe Institucionet tjera

Me ndryshimet e vazhdueshme në çmimet e energjisë elektrike dhe duke reflektuar aktivitetet e operimeve në KEK, kishte ndryshime në edhe në performancën financiare KEK gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin paraprak. Kjo ka ndikuar po ashtu edhe në detyrimet ndaj të autoriteteve licencuese si ZRRE dhe KPMM, por edhe ndaj ATK. Po ashtu ndryshimi në normat e interesit ka afektuar edhe interesin e pagueshëm ndaj aksionarit për huazimet nga Aksionari. Këto ishin € 40.5 milion në 2023, ose për €13.5 milion (25%) më të vogla krahasuar me vitin 2022.

Viti 2023 shfaq edhe zvogëlimin e shpenzimeve të tantimës për Linjitin ndaj KPMM, me një diferencë negative prej -15%, e cila tregon edhe zvogëlimin e nevojave të brendshme për konsum si rrjedhojë e ndalesave të blloqeve në përputhje me BVEE 2023. Kalkulimi dhe pagesa e rentës minerare, bëhet në bazë të raporteve periodike, për të cilat përgatiten dhe dorëzohen raporte të rregullta sipas kërkesave ligjore në KPMM, përfshirë pasqyrat financiare.

KEK ka kredi ndaj Ministrisë së Financave të cilën e paguan në afatet e rregullta dhe në dy këste vjetore sipas marrëveshjes së ri-programimit të borxhit me MF të vitit 2015. Po ashtu, gjatë vitit 2023 KEK ka generuar të ardhura prej € 16.3 milion, të cilat rezultojnë me shpenzime për tatime në vlerë prej €4 milion.

Institucioni	Lloji i shpenzimit/detyrimit	2023	2022	≠ vlerë	≠ përqindje
KPMM	Tantiema/ taksa e linjtit	(21,225)	(25,071)	(3,846)	-15%
MF	Interesi	(2,998)	(2,967)	31	1%
MF	Kthimi Huazimit	(11,387)	(11,387)	-	0.0%
ATK	Tatimet ne te ardhura të korporatave	(4,000)	(13,625)	(9,625)	-71%
ZRRE	Taksa vjetore e licencës	(859)	(881)	(22)	-2%
Gjithsej		(40,469)	(53,931)	13,462	-25%

Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen


Rreziqet dhe mundësitë bashkudhëtojnë në të njëjtën kohë. Krahas problemeve të dala nga kriza energjetike dhe së fundmi e sforcuar edhe nga lufta në Ukrainë dhe ajo në lindjen e mesme, projekte të tilla si ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese me pronësi nga KEK mund të jenë më lehtë të realizueshme sa i përket arsytimit dhe duke qenë në përputhje me kërkesat për ndotjen e ambientit. Disa nga mundësitë e identifikuar nga situatat e pasigurta me të cilat ballafaqohet KEK dhe që vazhdojnë të jenë të vlefshme edhe për 2024, janë si vijon:

- ✓ Rritja e çmimeve në bursa ka efekt pozitiv në të hyrat nga eksporti i energjisë së realizuar nga KEK. Kjo është vërejtur në të hyrat e realizuara nga eksporti i energjisë krahasuar mes viteve 2022 dhe 2023.
- ✓ KEK është në proces të draftimit të strategjisë së vet korporative e cila duhet të jetë në përputhje me strategjinë që Qeverisë së Kosovës për Energjinë. Kjo hap rrugën për definimin e një sërë procesesh të cilat tashmë një kohë të gjatë janë identifikuar si të nevojshme si psh. definimi i statusit të TCA dhe investimet e nevojshme në të.
- ✓ Plani i investimeve në minierën e re, duhet të shqyrtohet menjëherë pas strategjisë së KEK për të përcaktuar procesin e zhvillimit të minierës pas vitit 2027/2028, kur në bazë të planit xehetar pritet të përmbillet cikli jetësor i minierës ekzistuese.
- ✓ Ristrukturimi i korporatës sipas një skeme të re organizative të KEK sha.
- ✓ Plotësimi i nevojave të korporatës për resurse humane, si dhe zëvendësimi me kohë i vendeve vakant për të mos u rrezikuar operimet e biznesit.
- ✓ Projektet e ardhshme të energjisë së ripërtrishme. KEK është në fazë të rëndësishme të investimeve në energji të ripërtrishme.
- ✓ Përkundër aktiviteteve për përmirësimin e ambientit, për KEK mbetet sfida financimi i vazhdueshëm në përmirësimin (zvogëlimin) e ndotjes minimale të ambientit, ku kërkohet investime.

- ✓ Mosrealizimi i investimeve kapitale në kohë dhe me cilësi sfidojnë stabilitetin e prodhimit të energjisë.
- ✓ Anëtarësimi në Bursën ALPEX rrit mundësitë dhe fleksibilitetin e KEK në tregtimin e energjisë elektrike.
- ✓ Po ashtu, forcimi i bursës shqiptare të energjisë mund të lehtësojë detyrimet e ardhshme të Kosovën ndaj taksave të ndryshme për ambientin.
- ✓ Përkundër që minierat e KEK qëllim primar kanë prodhimin e thëngjillit për nevoja të termocentraleve të veta KEK për vitin 2024 e ka të planifikuar shitjen e thëngjillit në sasi prej rreth 500 mije ton. Shitja e thëngjillit jashtë vendit, (mbi çmimin e buxhetuar 29€/Ton), është një mundësi që KEK të siguroj të ardhura shtesë për investime strategjike. Kjo është e mundur, të vazhdohet në përputhje me kohën e ndalesave të gjata për remonte dhe ri-vitalizmit të njëjësive gjeneruese të termocentraleve.
- ✓ Në rast të ndonjë situatë hipotetike të përkeqësimit të gjendjes financiare në realizimin e buxhetit sidomos tek pjesa e të hyrave, KEK mund të shfrytëzoj të drejtën e shtyrjes së pagesës së rentës minerare sipas ligjit për miniera. Vlera e shpenzimeve të njohura për tantumën, në Pasqyra Financiare për vitin 2023 oshte € 21.2 milion. Ndërsa e buxhetuar për vitin 2024 është në vlerë prej €27.3 milion.
- ✓ Ri programimi i kredisë ndaj MF. Vlera e përlogaritur e detyrimit të këstit dhe interesit vjetor është € 14.21 milion. Kredia paguhet në dy këste vjetore 15 Prill dhe 15 Tetor.
- ✓ KEK ka fituar në shkallë të parë në procedurë gjyqësore kontestin ndaj ATK për kontrollet për periudhën 2010-2012. Për padinë në total prej 11 milion KEK pritet të inkasoj rreth € 4.5 milion. Pas animimit të ATK-së, lënda është në procedurë gjyqësore.

Fare në fund, pavarësisht sfidave, menaxhmenti i KEK-ut është i obliguar dhe përgjegjës të siguroj realizimin e qëllimit të korporatës për arritjen e stabilitetit në prodhimin e energjisë me kosto sa më të ulët dhe me ndikim minimal në ndotjen e ambientit.

Struktura Organizative KEK Sh. A



Pasqyrat Financiare

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023

Bilanci i Gjendjes

Në '000 euro	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022	≠ ne vlerë	≠ ne %
PASURITË				
Pasuritë afatgjata				
Prona, impiantet dhe paisjet	273,733	232,734	40,999	18%
Depozitat ne banka - pjesa afatgjate	80,621	96,900	(16,279)	-17%
Investimet në letra me vlerë afatgjatë	16,012	-	-	-
Pasuritë e paprekshme	386	618	(232)	-38%
	370,752	330,252	40,500	12%
Pasuritë afatshkurtra				
Inventarët	19,257	20,831	(1,574)	-8%
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, neto	57,658	77,365	(19,707)	-25%
Paraja në dorë dhe në bankë	48,365	97,127	(48,762)	-50%
Depozitat ne banka - pjesa afatshkurter	73,406	48,813	24,593	50%
Të arkëtueshme të shtyera për energjinë	-	2,313	-	-
Investime në letra me vlerë -afatshkurtër	34,907	-	-	-
	233,593	246,449	-12,856	-5%
GJITHSEJ PASURITË	604,345	576,701	27,644	5%
EKUITETI DHE DETYRIMET				
Ekuiteti i aksionarëve				
Kapitali aksionar	25	25	-	
Rezervat	207,407	198,472	8,935	4.5%
Rezervat/riVerësimi	44,728	-	-	
Fitimet/Humbjet e akumuluar	125,961	113,932	12,029	11%
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	378,121	312,429	65,692	21%
Detyrimet				
Detyrimet afatgjata				
Huazimet - pjesa afatgjatë	103,992	115,380	(11,388)	-10%
Grantet e shtyera	6,049	8,211	(2,162)	-26%
Provizionet	57,945	56,193	1,752	3%
Detyrimet e tatimit të shtyrë	8,275	9,648	(1,373)	-14%
	176,261	189,432	(13,171)	-7%
Detyrimet afatshkurtra				
Huazimet - pjesa afatshkurtër	11,996	12,026	(30)	-0.2%
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	13,870	21,456	(7,586)	-35%
Tatimi mbi të ardhura i pagueshëm	835	7,759	(6,924)	-89%
Grantet e shtyera - Importi i Energjisë	16,199	27,012	(10,813)	-40%
Të pagueshmet e shtyera të prodhimit energjisë	1,609	-	-	-
Shpenzimet akruale	5,454	6,587	(1,133)	-17%
	49,963	74,840	(24,877)	-33%
Gjithsej detyrimet	226,224	264,272	(38,048)	-14%
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET	604,345	576,701	27,644	5%

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Në '000 euro	2023	2022	≠ ne vlere	≠ ne %
Shitjet	180,824	283,517	-102,693	-36%
Të hyrat nga grantet	11,559	22,245	-10,686	-48%
Të hyrat tjera	767	1,851	-1,084	-59%
	193,150	307,613	-114,463	-37.2%
SHPENZIMET OPERATIVE				
Zhverësimi dhe amortizimi	-47,808	-48,462	654	-1%
Shpenzimet e personelit	-48,033	-47,027	-1,006	2%
Energjia elektrike dhe komunalitetë	-37,595	-53,025	15,430	-29%
Kostot e mirëmbajtjes	-2,902	-3,888	986	-25%
Materialet dhe furnizimet	-7,316	-4,963	-2,353	47%
Shpenzimet e linjtit	-21,225	-25,071	3,846	-15%
Provizionimet për shlyerjen e inventarit	3122	-216	3338	-1545%
Humbjet nga zhverësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera	-972	-4,500	3,528	-78%
Ndryshimi në provizione	-3,454	423	-3,877	-917%
Shpenzimet e shtyra të prodhimit të energjisë	-3,922	2,367	-6,289	-266%
Shpenzimet e tjera operative	-9,727	-6,551	-3,176	48%
	-179,832	-190,913	11,081	-6%
Fitimi nga operacionet	13,318	116,700	-103,382	-89%
Te hyrat / (Shpenzimet financiare), neto	3,002	1,588	1,414	89%
Fitimi para tatimit	16,320	118,288	-101,968	-86%
Shpenzimet e tatimit në fitim	-4,000	-13,625	9,625	-71%
Fitimi neto për vitin	12,320	104,663	-92,343	-88%
Të ardhurat tjera gjithpërfshirëse për vitin				
Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim dhe humbje				
Efekti i tatimit të shtyer në rivlerësimin pona, impiante dhe pajisje	628	624	4	1%
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin	12,948	105,287	(92,339)	-88%

Rrjedha e parasë së gatshme

(në EUR '000)	2023	2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi neto para tatimit	16,320	118,545
Rregullimet për zërat jomonetar		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	47,808	48,462
Amortizimi i granteve	-11,559	-22,245
Të hyrat nga interes	-6,964	-5403
Shpenzimet e interesit	2,967	3,906
Provizionimi i borxheve të këqija	972	4,500
Provizionet për investime financiare	-293	
Provizionimi për kostot e mjedisit dhe pensioneve	3454	-423
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	-3122	216
Rregullimi për energjinë e shkëmbyer	-1626	-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	65	44
Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative	48,022	147,602
Inventarët	4696	-758
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	23,277	-24,490
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	-8,749	13,040
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	67,246	135,394
Interesi i arkëtuar	4205	
Interesi i paguar	-3,034	-2,956
Tatimi mbi të ardhura i paguar	-11,670	-10,933
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative	56,747	121,505
Paraja nga aktivitetet investive		
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	-35,592	-10,108
Zvogëlim/(Rritje) në depozita	-58,529	-145400
Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive	-94,121	-155,508
Paraja nga aktivitetet financiare		
Grantet e pranuar për importin e energjisë		30,000
Pagesa e huazimeve	-11,388	-11,387
Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare	-11,388	18,613
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë	-48,762	-15,390
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	97,127	112,517
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	48,365	97,127

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

(në EUR' 000)	Kapitali aksionar	Rezervat	(Humbjet) e akumuluar	Rezerva e rivleresimit	Gjithsej
Gjendja më 01 Janar 2022	25	197,848	9,091		206,964
Transaksionet me pronarët					
Dividentat					
Fitimi i vitit			104,663		104,663
Korrigjimet e gabimeve			178		178
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		624			624
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		624	104,841		105,465
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	25	198,472	113,932		312,429
Gjendja me 01 Janar 2023	25	198,472	113,932		312,429
Transaksione me pronarin					
Fitimi për vitin			12,320		12,320
Korrigjimet e gabimeve			-291		-291
Kthimi i demtimit		8,307			8,307
Rezerva e rivleresimit				44,728	44,728
Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		628			628
Total te hyra tjera gjithëpërfshirëse		8,935	12,029	44,728	65,692
Gjendja Me 31 Dhjetor, 2023	25	207,407	125,961	44,728	378,121